



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË
SË INFORMACIONIT NË RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI



**MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT” NË
RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR**

TIRANË, JANAR 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	8
II	HYRJE	9
1.	Objekti i auditimit	9
2.	Qëllimi i auditimit	9
3.	Identifikimi i çështjes	9
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	10
5.	Përgjegjësitë e audituesve	10
6.	Kriteret e vlerësimit	10
7.	Standardet e auditimit	11
8.	Metoda e auditimit	11
9.	Dokumentimi i auditimit	11
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	12
2.1.	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	
	<i>a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.</i>	5-18
2.2.	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	
	<i>a. Investimet në teknologjinë e informacionit.</i>	18-35
2.3.	Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit	
	<i>a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.</i>	35-62
	<i>b. Procedurat e menaxhimit të ndryshimit, problemeve dhe incidenteve.</i>	
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	62
A	MASA ORGANIZATIVE	62

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi Emërtimi i Plotë

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
MAM	Media Asset Management
QSAN	Enterprise Data Storage & Data Management Solution
BCP	Business Continuity Plan
ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
BCC	Business Continuity Center
MNSH	Marrëveshjeve Nivel Shërbimi
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operator Ekonomik
TI(IT)	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
BE	Bashkimi Evropian
SSL	Secure Sockets Layer
VPN	Virtual Private Network
LAN	Local area network
IP	Internet Protocol

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një auditim të Teknologjisë së Informacionit në Radio Televizionin Shqiptar, nga data 15.09.2023 deri më datë 13.11.2023.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Radio Televizionin Shqiptar është pjesë e Planit Vjetor 2023 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi është bërë bazuar në një analizë risku si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Radio Televizionin Shqiptar disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Mbështetur në punën në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese. Rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar. Nga ana e RTSH nuk ka patur observacione lidhur me Projektraportin e auditimit. Auditimi i sistemeve të Informacionit është i rëndësishëm për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetje nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	<p>Nga auditimi u konstatua se RTSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me praktikën më të mirë, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion; rregulla mbi menaxhimin e incidenteve; procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre; struktura kontrolli për verifikimin e efektivitetit të ndryshimeve të kryera; procedura për ndryshimet emergjente si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve.</p>	<p>Faqe 5-18</p>	<p>E Lartë</p>	<p>RTSH të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të shoqërisë si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.</p>
2	<p>Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor”, për vitin 2021, në kontratën e lidhur midis Autoriteti Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik fitues nuk është përcaktuar shprehimisht dërgimi i raporteve mujore të mirëmbajtjes nga ana e operatorit ekonomik. Funksionimi i sistemit mbikëqyret vetëm nga grupi i punës për marrjen në dorëzim i cili harton një procesverbal çdo muaj në momentin e pagesës së faturës nga RTSH, ndërsa operatori ekonomik nuk mban asnjë raport mujor për monitorimet përkatëse të ecurisë, KPI-ve apo problematikave të pajisjeve Mediakind Ericsson C2 Box</p>	<p>Faqe 18-35</p>	<p>E Lartë</p>	<p>RTSH të marrë masa që në hartimin e kontratave për mirëmbajtjen e sistemeve në të ardhmen, të mirëpërcaktojë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë me qëllim matjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të kontraktuara.</p>

	System. Pra, detyrën e OE e ka kryer grupi i marrjes në dorëzim, i cili, njëkohësisht, merr në dorëzim mbikëqyrjen që ka bërë vetë.			
3.	Nga auditimi u konstatua se, sistemi MAM, QSAN dhe EPG, administrohen nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, pa një akt rregullativ për administrimin/menaxhimin e sistemit, në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e sistemit dhe përdoruesve të sistemit. Gjithashtu administratorët e sistemeve dhe detyrat përkatëse nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga organet drejtuese të RTSH, ku të jenë emëruar zyrtarisht për të ushtruar atributet e përcaktuara sipas funksioneve dhe detyrave mbi administrimin e sistemit.	Faqe 35-62	E Lartë	Strukturat drejtuese në RTSH të marrin masa për përcaktimin e administratorit/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që RTSH ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT. Gjithashtu, RTSH të marrë masa për hartimin dhe miratimin e manualeve të përdorimit përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e fjalëkalimeve, ndryshimin e roleve dhe të drejtave të përdoruesve të RTSH.
4.	Nga auditimi u konstatua se, storage i Isilon Data Storage me një hapsirë storage rreth 912.55 TB ku ruhen të gjitha materialet multimediale online të ruajtura ndër vite ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit të mundshëm për ruajtjen e materialeve arkivore. Nga auditimi mbi sistemin MAM, u konstatua se: - Sistemi MAM nuk është shfrytëzuar dhe nuk është përdorur nga RTSH si një sistem informatik i menaxhimit të aseteve Multimediale, me qëllim ndërlidhjen dhe	Faqe 35-62		Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit si dhe Drejtorinë e Arkivës të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me qëllim vlerësimin, analizimin dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete në lidhje me menaxhimin e file-ve të ruajtura në storage e sistemit MAM. Gjithashtu RTSH të marrë masa për mos lënien e sistemit pa mirëmbajtje duke ngritur grupe pune të brendshme për mirëmbajtjen

	<p>shkëmbimin e informacioneve të të gjitha nënsistemeve të tjera si për playout, livestream, VOD (platforma OTT) etj,</p> <p>- Për një periudhë 1 vjeçare sistemi MAM është pa mirëmbajtje;</p> <p>RTSH ka patur 2 specialistë të certifikuar për përdorimin e sistemit MAM, të cilët i kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me RTSH dhe aktualisht sistemi MAM nuk menaxhohet dhe administrohet nga asnjë punonjës i autorizuar. Në kushtet aktuale që ndodhet ky sistem dhe mënyra sesi menaxhohet, rrezikon ndërprerjen dhe e bënë të pamundur për ta rikthyer sistemin në gjendjen fillestare.</p>			<p>dhe menaxhimin e sistemit/storage si dhe trajnim e stafit në lidhje me sistemin MAM, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.</p>
<p>5.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se, shërbimet që ofrohen me anë të teknologjisë së informacionit në RTSH mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe një pjesë e saj është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet, konkretisht:</p> <p>-Pajisjet PC të disa pikave të montazhit dhe grafikës janë me parametra minimale të gjenerimit të materialeve video+audio;</p> <p>-Pajisjet PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 85%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të RTSH-ës vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe;</p> <p>-Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;</p>	<p>Faqe 35-62</p>		<p>RTSH të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standartizimin e infrastrukturës IT sipas praktikave më të mira, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje dhe ofrimin e shërbimeve duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike në RTSH, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.</p>

<p>-Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluara nëpër pc janë të pa licencuara;</p> <p>-Pjesa e rrjetit të brendshëm është e menaxhuar me anë të switch-eve të cilat janë lidhur sipas nevojës dhe sipas rastit nga specialistët IT dhe nuk disponohet një router qendror për të bërë transkriptimin e IP për të gjithë rrjetin e RTSH, e cila sjell risk në ndërhyrjen në sistemit të brendshëm të televizionit;</p> <p>-Firewall-i për sigurinë e rrjetit është aktiv por i palicensuar, çka sjell çaktivizimin e të gjitha faktorëve të mbrojtjes kur firewall-i është jashtë garancisë, gjë që mund të paraqesë rreziqe sigurie për rrjetin e networkut të gjithë RTSH-ës.</p>			
---	--	--	--

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2021-30.06.2023, në të cilat përfshihet Qeverisja IT, Siguria e Informacionit, Investimet në fushën TIK dhe sistemet e teknologjisë së informacionit që RTSH ka në përdorim dhe mbështet aktivitetin e saj.

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014.

Kemi vlerësuar se Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur problemet e sigorisë së informacionit, si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit.

Zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë. Si rezultat i investimeve në sisteme të reja, disa prej sistemeve ekzistuese nuk gjejnë më përdorim pasi funksionalitetet e tyre janë zëvendësuar nga sisteme të reja. Megjithatë, edhe sistemet e reja kanë shfaqur një sërë problematikash të cilat lidhen me kapacitetin storage, duke vështirësuar menaxhimin e sistemit dhe mundësinë për ndërprerje dhe mosfunksionim i sistemit në të ardhmen.

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në RTSH mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar, duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet. Paisjet fizike, programet softuerike të cilat ndërveprojnë në mënyrë që sistemet të operojnë, janë të papërditësuara e nuk kanë suportin e prodhuesit.

Sipas opinionit tonë, pas shqyrtimit të evidencave të marra, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigorisë së të dhënave, si dhe të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit është i pamjaftueshëm.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 600/1, datë 15.09.2023 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 15.09.2023 deri në 13.11.2023, në Radio Televizionin Shqiptar (më poshtë RTSH), ku periudha e audituar është 01.01.2021 deri në 30.06.2023, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. D.B, anëtar
3. K.S, anëtare
4. R.K anëtar

II.1. Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Radio Televizionin Shqiptar, është dhënia e opinionit apo vlerësimit nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Për të arritur në dhënien e një opinionit, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efçente. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

II.3 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.600/1, datë 15.09.2023:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.

2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit

a. Investimet në teknologjinë e informacionit.

3. Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit

c. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.

d. Procedurat e menaxhimit të ndryshimit, problemeve dhe incidenteve.

4. Të tjera

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

RTSH është person juridik publik, jo me qëllim fitimi, me seli në Tiranë, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në bazë të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, rregulla të mjaftueshme për garantimin e funksionimit normal të RTSH përcaktohen në Statutin e saj, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”.

RTSH-ja e kryen veprimtarinë e vet mbështetur në:

- a) drejtimin ekonomik - financiar të decentralizuar;
- b) prodhimin e programeve audio dhe audiovizive për transmetim në RTSH dhe për të tretët;
- c) transmetimin audio dhe audiovizive për programin e RTSH-së dhe për të tretët.

RTSH-ja ka këtë strukturë organizative:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së;
- b) Njësia e Programeve;
- c) Njësia e Teknikës;
- d) Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve;
- e) Qendrat vendore audiovizive (Kukës, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër).

II.5 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Radio Televizionin Shqiptar, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 30.06.2023, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 600/1, datë 15.09.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislationin e fushës në të cilën operon RTSH. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165).
- Ligji nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
- Ligji Nr. 162 Date 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.
- Ligji nr. 97, datë 4.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij.
- Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- VKMnr.710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar.
- Standardet TIK.
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 "për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit", i ndryshuar.
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.7 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310 etj.

II.8 Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në RTSH, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi.

II.9 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Radio Televizioni Shqiptar është një institucion publik i një rëndësie të veçantë kombëtare (që kryen një shërbim publik në fushën e medias audiovizive, me qëllimin për të siguruar nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe të shqiptarëve në mbarë botën.

Themeluesi i institucionit publik të Radio Televizionit Shqiptar është shteti shqiptar. Shteti Shqiptar garanton autonominë institucionale dhe pavarësisë editoriale të Radio Televizionit Shqiptar, si dhe merr përsipër financimin e domosdoshëm për të bërë të mundur kryerjen e shërbimit publik në fushën e medias audiovizive nga RTSH.

Prej vitit 1993 RTSH-ja transmeton programet e saj radiofonike dhe televizive edhe nëpërmjet satelitit, dhe aktualisht transmeton në 12 kanale televizive kombëtare, 3 kanale televizive lokale dhe 8 kanale radiofonike.

Sipas strategjisë kombëtare të digjitalizimit, është realizuar kalimi nga transmetimet analogë në ato numerike, një proces me rëndësi kombëtare dhe një nga investimet më të mëdha të RTSH që nga krijimi i saj.

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, si menaxher kryesor i këtij sistemi, përfaqëson RTSH-në dhe vepron në emër të këtij institucioni në të gjitha marrëdhëniet juridike me persona të tretë, në të gjitha transaksionet ku palë është RTSH-ja, përveç atyre të pasurive të paluajtshme. Në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, RTSH-ja përfaqësohet nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe në mungesë të tij, nga njëri prej drejtuesve të lartë të njësive administrative në përbërje të RTSH-së, i cili autorizohet me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm. Bordi i Administrimit të RTSH-së është organ këshillimor i Këshillit Drejtues të RTSH-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 111, pika 9, të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” për çështjet e administrimit dhe për çështjet financiare e të biznesit të RTSH-së.

2. Përshkrimi i rezultateve të auditimit

2.1 Auditimi i Funkcionimit të Qeverisjes Tik

a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.

Qeverisja në Teknologjinë e Informacionit

Burimet njerëzore, aktet rregullative, identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në teknologjinë e informacionit.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Rregullorja e brendshme e RTSH;
- Struktura e përgjithshme organizative e miratuar e institucionit;
- Lista e të gjithë punonjësve IT sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë si dhe përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi;
- Organigrama;
- Aktet rregullative që lidhen me sistemet dhe veprimet operationale brenda dhe jashtë sistemit;
- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;
- Gjithashtu, grupi i auditimit mblodhi informacione duke zhvilluar pyetësorë e intervista me stafin e RTSH dhe mbi informacionin e mbledhur u zhvilluan analizime.

➤ *Burimet njerëzore*

Në mbështetje të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, organet drejtuese të RTSH-së janë:

- a) Këshilli Drejtues (KDRTSH);
- b) Drejtori i Përgjithshëm;
- c) Bordi i Administrimit.

Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në strukturën e miratuar RTSH ka një numër total prej 1039 punonjësish, nga të cilat 81 janë pozicione vakante. Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (DTI), e përbërë nga 9 punonjës, nga të cilat dy pozicione janë vakante. Pozicionet vakante në këtë drejtori janë kyçe pasi janë përkatësisht pozicioni i Drejtorit (aktualisht i komanduar) dhe i ai Inxhinierit IT. Aktualisht, është komanduar si drejtor drejtorie z. A.N, i cili ka qenë dhe pika e kontaktit për marrjen dhe koordinimin e informacionit dhe të dhënave për grupin e auditimit.

Drejtoria e IT e ushtron veprimtarinë e saj në 3 turne pune për të mbuluar nevojat Institucionale. Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në RTSH për periudhën e auditimit rezulton se ka pasur luhatje të vazhdueshme në Burimet njerëzore, shoqëruar me vende vakante të strukturës në disa prej pozicioneve të rëndësishme në Drejtori, mbart riskun e përmbushjes së misionit dhe funksioneve kryesore si sigurimi dhe realizimi i shërbimeve operationale.


Tabela nr.1: Struktura IT

Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (DTI)		Emërtesa	Arsimi	Fillimi në RTSH
1		Drejtor		
2	F.V	Inxhinier IT	Inxhinieri telekomunikacioni	02.09.2019
3		Inxhinier IT		
4	A.N (Komandohet Drejtor)	Specialist IT	I larte Inxh. Kompjuterike	24.10.2022
5	E.J	Specialist IT	Master Tek. informacioni	19.09.2022
6	L.M	Specialist IT	Bachelor/master Inxhinieri Informatike	01.08.2022
7	G.Z	Specialist IT	Bachelor/Informatike e aplikuar	03.10.2022
8	S.B	Specialist IT	Inxhinieri Siguri Kibernetike	03.02.2020
9	A.R	Specialist IT	Bachelor teknologji informacioni	01.08.2023

Burimi: RTSH/ Përpunoi: Grupi i Auditimit

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit nuk ka kryer një ndarje të detyrave të specialistëve IT duke qenë se RTSH ka shumë drejtori të cilat kanë nevojë për asistencën e Specialistëve IT si Njësia Teknike në Radio, Televizion dhe Administrata e Institucionit.

Organigrama e RTSH



Burimi: RTSH/Përpunoi: Grupi i Auditimit

➤ **Trajnimet**

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga komunikimet verbale me subjektin, u konstatua se specialistët e TI në RTSH nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni dhe strukturat drejtuese në RTSH nuk kanë një plan të hartuar dhe miratuar mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.. Mungesa e trajnimeve sipas fushave përkatëse për sektorin e teknologjisë së informacionit bën që për pasojë ata të mos mund të zbatojnë si duhet detyrat e përcaktuara në përshkrimet e punës sipas rregullores dhe statutit të RTSH.

Nga auditimi nuk u administrua dokumentacion mbi propozimet përkatëse nga niveli menaxherial i RTSH për zhvillimin e trajnimeve. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim, duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

➤ *Verifikimi i politikave dhe procedurave në TIK*

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret e institucionit, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikatat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

Nga auditimi u konstatua se Teknologjia e Informacionit në RTSH zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullore. RTSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikatat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion; rregulla mbi menaxhimin e incidenteve; procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre; struktura kontrolli për verifikimin e efektivitetit të ndryshimeve të kryera; procedura për ndryshimet emergjente si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve. Mungesa e bazës së brendshme rregullore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje dhe jo sipas procedurave të përcaktuara, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

➤ *Transparenca e veprimtarisë së RTSH-së*

Funksionimi i RTSH-së duhet të jetë transparent, gjithashtu, në shërbim të publikut. RTSH-ja vë në qarkullim një botim periodik, ku publikohen të dhëna të hollësishme për situatën financiare të institucionit. RTSH-ja duhet të bëjë publike në faqen zyrtare të internetit: ligjin, statutin, raportin vjetor të veprimtarisë së tij, përfshirë edhe atë financiar, vendet e lira të punës, rezultatet e vlerësimit të kandidatëve dhe shpalljen e fituesit, vendimet e Këshillit Drejtues, planin strategjik të miratuar nga KD i RTSH-së, parimet editoriale, burimet e financimit dhe shpenzimet vjetore, kontratën e lidhur me AMA-n, si dhe raportet vjetore të Këshillit të Dëgjuesve dhe Shikuesve dhe atij të Bordit të Administrimit.

Nga auditimi mbi transparencën e veprimtarisë së RTSH-së, grupi i auditimit konstatoi se raportet vjetore të veprimtarisë së RTSH-së nuk janë publikuar në faqen e web-it në kundërshtim me nenin 35, pika 2 e statutit të RTSH-së, ku citohet se: “Raporti vjetor duhet të publikohet në një botim të veçantë dhe në faqet zyrtare të internetit të RTSH-së.” Gjithashtu, grupi i auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë raport mbi veprimtarinë vjetore të RTSH-së për vitet të cilat përfshijnë periudhën e auditimit. Konstatohet se për periudhën objekt auditimi, RTSH nuk ka hartuar dhe publikuar raportet vjetore të veprimtarisë së institucionit në kundërshtim me nenin 102 “Kompetencat e KDRTSH”, pika 18, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ku citohet se: “KDRTSH-ja ka këto kompetenca: “Hartoni raport për veprimtarinë vjetore të RTSH-së, në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe ia paraqet atë Kuvendit në fund të muajit mars të çdo viti për vitin paraardhës.”

➤ *Mbi auditin e brendshëm*

Njësia e auditimit të brendshëm është e organizuar në nivel Drejtorie e përbërë nga një Drejtor dhe dy auditues. Misioni i njësies së auditimit të brendshëm, si pjesë e strukturës të RTSH është orientimi i veprimtarisë, në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke dhënë garanci të arsyeshme, për efikasitetin, efektivitetin, ekonomikitetin e menaxhimit të burimeve, përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut. Ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në RTSH për periudhën 01.01.2021-30.06.2023 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenin 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në

sektorin publik”. “Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me:

- standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;
- këtë ligj dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit.
- të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6, nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

➤ **Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit:**

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: rreziku që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e IT në RTSH. Nga administrimi i dokumentacionit se si RTSH identifikon dhe menaxhon risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se RTSH nuk disponon një regjistër risku, ku të përfshihen dhe risqet mbi IT, në mospërputhje me: nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike.”

1.Titulli i Gjetjes:	Ndryshime të shpeshta dhe të vazhdueshme të burimeve njerëzore.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se në strukturën e miratuar RTSH ka një numër total prej 1039 punonjësish, nga të cilat 81 janë pozicione vakante. Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (DTI), e përbërë nga 9 punonjës, nga të cilat dy pozicione janë vakante. Pozicionet vakante në këtë drejtori janë kyçe pasi janë përkatësisht pozicioni i Drejtorit (aktualisht i komanduar) dhe i ai Inxhinierit IT.
Kriteri:	Standardet ndërkombëtare të TIK në organizimin funksional të strukturave.
Ndikimi/efekti:	Risk në mospërmbushje të objektivave të përcaktuara dhe funksioneve kryesore.
Shkaku:	Nuk janë marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante.
Rëndësia:	E lartë
1.1 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për plotësimin e kapaciteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.

2.Titulli i Gjetjes:	Mosndarje detyrash në Drejtorinë e IT.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit nuk është kryer ndarja e detyrave dhe përgjegjësi të specialistëve të IT edhe pse nevoja për asistencën e Specialistëve IT

	është e madhe, sidomos nga Njësia Teknike në Radio, Televizion dhe Administrata e Institucionit.
Kriteri:	Standardet ndërkombëtare të TIK në organizimin funksional të strukturave.
Ndikimi/efekti:	Risk në mospërbushje të objektivave të përcaktuara dhe funksioneve kryesore të Drejtorisë.
Shkaku:	Paqartësi mbi rëndësinë e ndarjes së detyrave në TIK dhe mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.
Rëndësia:	E Mesme
2.1 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për përditësimin e rregullores duke bërë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi të specialisteve IT në institucion, në mënyrë që të gjitha drejtoritë të kenë suportin e nevojshëm për kryerjen e objektivave të caktuara.

3.Titulli i Gjetjes:	Mungesë trajnimesh për rritjen e kapacitetit teknik në strukturën e punonjësve të TI.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se specialistët e TI në RTSH nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni dhe strukturat drejtuese në RTSH nuk kanë një plan të hartuar dhe miratuar mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtjshëm të tyre.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e trajnimeve sipas fushave përkatëse për sektorin e teknologjisë së informacionit mund të sjellë moszbatimin e detyrave të përcaktuara.
Shkaku:	Moszbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.
Rëndësia:	E mesme.
3.1 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime për rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtjshëm të punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që të nxis dhe të përmirësojë kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional.

4.Titulli i Gjetjes:	Mungesë e bazës rregullatore të Teknologjisë së Informacionit.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se RTSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion; rregulla mbi menaxhimin e incidenteve; procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e

	ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre; struktura kontrolli për verifikimin e efektivitetit të ndryshimeve të kryera; procedura për ndryshimet emergjente si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve.
Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e bazës rregullatore mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.
Shkaku:	Moszbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të shoqërisë si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

5.Titulli i Gjetjes:	Menaxhimi i risqeve në TIK.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se raportet vjetore të veprimtarisë së RTSH-së për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar nga Këshilli Drejtues i RTSH, si dhe nuk janë të publikuara në faqen e saj të web-it.
Kriteri:	Nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e regjistrimit të riskut mund të cenojë përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në RTSH.
Shkaku:	Moszbatimi i dispozitave ligjore dhe praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.
Rëndësia:	E lartë.
5.1 Rekomandimi:	Këshilli Drejtues dhe RTSH të marrin masa për hartimin dhe publikimin në faqen web ta raporteve vjetore të veprimtarisë së institucionit sipas përcaktimit të dispozitave ligjore në fuqi.

6.Titulli i Gjetjes:	Mungesa e kryerjes së Auditimeve IT nga Auditi i Brendshëm.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në RTSH për periudhën 01.01.2021-30.06.2023 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit.

Kriteri:	Nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.
Ndikimi/efekti:	Moskryerja e auditimeve të TI zvogëlon shkallën e llogaridhënies institucionale dhe dobëson kontrollin e brendshëm në RTSH.
Shkaku:	Moszbatimi i dispozitave ligjore dhe standardave në auditimin e brendshëm publik.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime IT, me qëllim ekzaminimin e sistemeve të IT për të garantuar se ato përmbushin nevojat e subjektit pa komprometuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së RTSH.

7.Titulli i Gjetjes:	Transparenca e veprimtarisë së RTSH.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në RTSH, për periudhën objekt auditimi, nuk ka zhvilluar asnjë auditim me fokus mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Kriteri:	Neni 35, pika 2 e statutit të RTSH-së; Neni 102 “Kompetencat e KDRTSH”, pika 18, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” .
Ndikimi/efekti:	Mungesa e bazës rregullatore mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.
Shkaku:	Moszbatimi i dispozitave ligjore dhe praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Këshilli Drejtues dhe RTSH të marrin masa për hartimin dhe publikimin në faqen web ta raporteve vjetore të veprimtarisë së institucionit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Aktkonstatimi nr.1, datë 13.11.2023, protokolluar në RTSH me nr. 2006/1, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 05-10 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

2.Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

Bazuar në pikën nr.2 të programit të auditimit “Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit”, pas marrjes së informacionit nga nëpunësit si dhe pas verifikimit të sistemit, RTSH për periudhën nën auditim 01.01.2021- 30.06.2023 ka zhvilluar procedurat e mëposhtme të prokurimit me vlerz ndarë sipas viteve:

- 1- Lista e prokurimeve TIK të periudhës 01.01.2021 – 30.06.2023.
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas bazës së riskut.
- 3- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve.
- 4- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim.
- 5- Sistemi elektronik i APP për procedurat e RTSH.

Tabela nr.2.Regjistri i Realizimeve për periudhën 01.01.2021-30.06.2023

Viti	Procedura e Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik	Data e Lidhjes së kontratës
2021	Blerje Kompjuter për RTSH-ne	800,000	769,600	P.S	9/9/2021
	Blerje pajisje dhe software (program) për posten elektronike ne RTSH	5,500,000	5,200,000	P.S	4/14/2021
	Shërbim Mirëmbajtje Për Head-End-In Satelitor	15,626,666	11,676,000	P.S	9/9/2021
2022	“Blerje PC dhe kartë audio për nevojat e RTSH”	3,207,333	2,823,700	P.S	12/29/2022
	“Blerje pjesë këmbimi për kompjuterat e montazhit”	974,000	650,000	A.B	1/07.2021
2023	Blerje Sistem LTO 9 për nevojat e RTSH-së	21,748,515	16,300,000	T SHPK	10/10/2022
	“Blerje pjese dhe materiale për pajisje kompjuterike për nevoja te RTSH”	3,283,233	189,000	P.S	15.05.2023

1. Mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje kompjuter për RTSH”:

Tabela 1: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 96018-05-20-2021

1. Urdhër Prokurimi: nr. 36/3, datë 20.05.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: 1. F.V	4. Komisioni i përllogaritjes se fondit limit: 1. F.Z 2. G.H 3. K.B
2. Fondi Limit (pa TVSh) 790,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “me vlera të vogla”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: 1. F.Z 2. G.H 3. K.B	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1. F.Z 2. G.H 3. K.B
8. Data e hapjes së tenderit: 21.05.2021	9. Operatori fitues: P.S Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 769,600 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 21,000 lekë
11.Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 21 (njëzet e një)	12. Operatore të Kualifikuar: 17 (shtatëmbëdhjetë)	13. Operatorë të skualifikuar: 4 (katër)
14. Ankimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 14868/7 prot, datë 03.11.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 769,600 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë: marrja në dorëzim e mallit menjëherë
Ndjekësit e kontratës: 1. F.Z, 2. G.H, 3. K.B dhe E.B (Specialist IT)		

Kjo procedurë prokurimi ka qenë e parashikuar në Regjistrin e Parashikimeve për vitin 2021 me fond të përllogaritur në vlerën 790,000 lekë dhe lloji i procedurës me vlerë të vogël.

- Me kërkesën nr. 1148 prot., datë 30.03.2021 Kryetari i KDRTSH i ka kërkuar DP të RTSH pajisjen me copë 2 (dy) kompjutera me qëllim zhvillimin e veprimtarisë së Këshillit Drejtues, kërkesë e cila është miratuar nga DP i RTSH.

- Me Urdhrin nr. 36, datë 17.05.2021 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt “Blerje kompjuter” me përbërje: 1. Z. F.V.

- Më datë 18.05.2021 janë hartuar specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për: 1. Kompjuter zyre (copë 1), 2. Kompjuter all-in-one (copë 2).

- Pas studimit paraprak të tregut duke i bërë kërkesë 3 operatorëve ekonomikë, më datë 20.05.2021 është mbajtur procesverbali i argumentimit të fondit limit në vlerën 790,000 lekë pa tvsh nga Komisioni i Prokurimit me Vlëra të Vogla (KPVV): 1. F.Z 2. G.H 3. K.B..

- Me urdhrin e prokurimit nr. 36/3, datë 20.05.2021, titullari i Autoriteti Kontraktor ka kërkuar nisjen e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kompjuter për RTSH-në”.

- Me shkresën nr.36/4 prot., datë 20.05.2021, AK ka hartuar Ftesën për Ofertë duke njoftuar dhe datën e zhvillimit të procedurës më 21.05.2021, ora 13:00.

- Më datën 21.05.2021 është mbajtur procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje Kompjuter për RTSH” nga anëtarët e KPVV. Në këtë procedurë paraqitën ofertat në mënyrë elektronike 21 operatorë ekonomikë. Komisioni, pas vlerësimit të ofertave ekonomike dhe renditjes përfundimtare, operatorët si më poshtë janë refuzuar për arsye se nuk e kanë patur të përfshirë objektin e prokurimit në QKB: 1. D&J, 2. S.RR. Ndërsa operatorët “A-k” dhe “OT” janë skualifikuar pasi nuk janë paraqitur ose nuk kanë njoftuar në sistemin elektronik për mospjesëmarrjen e tyre.

- Nga renditja përfundimtare, në bazë të çmimit më të ulët, operatori “F” u shpall fitues me ofertën me vlerë 215,000 lekë pa TVSH.

- Më datë 25.05.2021, operatori “F” u skualifikua pasi nuk u paraqit ose nuk njoftoi në sistemin elektronik mospjesëmarrjen e tij, duke u përjashtuar nga të gjitha procedurat e prokurimit me vlëra të vogla që do të zhvilloheshin nga AK në vitin 2021, sipas Udhëzimit nr. 3, datë 08.01.2018, pika 14 “Refuzimi i ofertave”, gërma “b”.

- KPVV kaloi tek operatori i klasifikuar i dyti, e kështu me radhë deri tek operatori i renditur në vend të dhjetë “PS”, pasi ato pararendës nuk janë shpallur fitues për shkak se ose kanë njoftuar për gabim në përllogaritje fondi dhe janë tërhequr, ose nuk janë paraqitur/nuk kanë njoftuar për mospjesëmarrje nëpërmjet sistemit elektronik. Janë skualifikuar, kështu, edhe operatorët e tjerë: Hest, G-D, I, JB, EK & T P, O.H, KPVV kaloi, kështu, tek operatori i renditur i dhjeti “PS” me ofertë me vlerë 769,600 lekë pa tvsh.

- Më datë 07.06.2021, OE “PS” paraqiti dokumentacionin e kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe u kualifikua.

- Më datë 08.06.2021, Komisioni i Prokurimit me Vlëra të Vogla i përbërë nga: 1.F.Z, 2. G.H. 3. K.B, së bashku me specialistin e fushës z. E.B (specialist IT), bëri marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar. Nga verifikimi i mallit të lëvruar nga operatori ekonomik, rezultoi se ato janë në përputhje me cilësinë e kërkuar sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë e, si rrjedhojë, iu bë hyrje në magazinën e RTSH-së.

- Në datën 09.06.2021, OE ka gjeneruar faturën tatimore me nr. 104/2021 në vlerën 923,000 me TVSH për t’u likuiduar nga RTSH për lëvrimin e mallit të prokuruar.

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuar”, të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar.

2. Mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje pjesë këmbimi për kompjuterat e montazhit”:

Tabela 2: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 33813-06-22-2022

1. Urdhër Prokurimi: nr. 2368, datë 22.06.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike:	4. Komisioni i përlogaritjes se fondit limit:
2. Fondi Limit (pa TVSh) 974,000 lekë	1. H.M	1. E.P 2. M.P 3. K.B
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “me vlera të vogla”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kritereve të veçanta: 1. E.B 2. K.B 3. M.P	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1. E.B 2. M.P 3. N.M
8. Data e hapjes së tenderit: 23.06.2022	9. Operatori fitues: A.B Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 650,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 324,000 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 11 (njëmbëdhjetë)	12. Operatore të Kualifikuar: 11 (njëmbëdhjetë)	13. Operatore të s’kualifikuar: Nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 2368/6 prot, datë 01.07.2022	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 650,000 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë: brenda 10 ditësh nga lëvrimi i mallit
Ndjekësit e kontratës: 1. O.H, 2. J.S, 3. K.B		

Kjo procedurë prokurimi ka qenë e parashikuar në Regjistrin e Parashikimeve për vitin 2022 me fond të përlogaritur në vlerën 974,000 lekë dhe lloji i procedurës me vlerë të vogël.

- Më datë 06.05.2022, drejtuesi i Njesisë Teknike në RTSH i bën kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm mbi nevojën për riparimin e kompjuterave të montazhit të emisioneve “Mirëmëngjes Shqipëri” dhe “Si në familje” dhe blerjen e mallrave të mëposhtme, për t’iu rikthyer gjendjes normale të punës:

- 4 (katër) karta grafike
- 4 (katër) HDD nga 4 TB
- 4 (katër) SSD 512 GB

Për këto pjesë këmbimi janë hartuar dhe specifikimet teknike përkatëse nga sektori IT.

- Me shkresën nr. 1628/1 prot., datë 12.05.2022, titullari i AK, ka dërguar kërkesën për ofertë pranë 3 OE, përkatësisht “PS”, “R” dhe “I-P”, me qëllim studimin paraprak të tregut dhe përlogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit. Me anë email-i, të tre operatorët ekonomikë përgjigjen se pajisjet e kërkuara nuk prodhohen nga to. Për këtë arsye, Njësia Teknike kërkon rishikimin e specifikimeve teknike. Më datë 19.05.2022, drejtuesi i Njesisë Teknike harton specifikimet e reja teknike të pajisjeve të kërkuara.

- Me shkresën nr. 1628/6 prot., datë 26.05.2022, titullari i AK, ka dërguar sërish kërkesën për ofertë pranë 3 OE, me specifikimet e reja teknike, përkatësisht “PS”, “R” dhe “I-P”, me qëllim studimin paraprak të tregut dhe përlogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit.

- Pas marrjes së ofertave nga OE, më datë 17.06.2022 Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla (KPVV) me përbërje 1. Z. E.P, 2. Znj. M.P, 3. Znj. KB, ka mbajtur proceverbalin e

argumentimit të fondit limit, duke përcaktuar vlerën mesatare totale pa TVSH, bazuar në çmimet e ofertuara, në 974,000 lekë.

- Me urdhrin e prokurimit nr.2368 prot., datë 22.06.2022, titullari i Autoriteti Kontraktor ka kërkuar nisjen e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë këmbimi për kompjuterat e montazhit”.

- Me shkresën nr.2368/1 prot., datë 22.06.2022, AK ka hartuar Ftesën për Ofertë duke njoftuar dhe datën e zhvillimit të procedurës më 23.06.2022, ora 13:00.

- Më datën 24.06.2022 është mbajtur procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë këmbimi për kompjuterat e montazhit” nga anëtarët e KPVV: 1. E.B. 2. M.P dhe 3. N.M. Në këtë procedurë paraqitën ofertat në mënyrë elektronike 11 operatorë ekonomikë.

- Nga renditja përfundimtare, në bazë të çmimit më të ulët, operatori “A.B P.F” u shpall fitues me ofertën me vlerë 650,000 lekë pa TVSH. Më datë 30.06.2022, pasi u prit afati i ankesave prej dy ditësh, u konfirmua fitues OE i lartpërmendur.

- Më datë 01.07.2022, RTSH dhe OE “A.B” lidhën kontratën e furnizimit me nr. 2368/6 prot., në vlerën 650,000 lekë pa TVSH.

- Më datë 07.07.2022, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH urdhëroi ngritjen e grupit të punës për marrjen e mallit në dorëzim sipas kontratës së mësipërme dhe me përbërje si vijon: 1.O.H, 2. J.S 3. K.B.

- Më datë 12.07.2022, grupi i punës bëri marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar. Nga verifikimi i mallit të lëvruar nga operatori ekonomik, rezultoi se ato janë në përputhje me cilësinë e kërkuar sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë e, si rrjedhojë, iu bë hyrje në magazinën e RTSH-së.

3. Mbi procedurën e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor”:

Tabela : Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 87225-02-16-2021

1. Urdhër Prokurimi: nr. 68/3, datë 11.02.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: 1. F.V	4. Komisioni i përlogaritjes së fondit limit: 1. A.B. 2. F.Z 3. K.B
2. Fondi Limit (pa TVSh) 15,626,666 lekë për 36 muaj		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur (Marrëveshje Kuadër)”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: 1. G.A 2. F.Z 3. G.N	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1. D.K 2. M.A 3. K.B
8. Data e hapjes së tenderit: 12.03.2021, ora 10.00	9. Operatori fitues: “T” shpk me ofertë 11,676,000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 21,000 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 68/16 prot, datë 14.04.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 14.011,200 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë: për 36 muaj
Ndjekësit e kontratës: 1. M.M, 2. G.N, 3. R.V		

a. *Specifikimet teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit*

- Më datë 09.12.2020, Drejtuesi i Njësisë Teknike i ka kërkuar DP të RTSH kërkesë për suport për sistemin Head-End që siguron transmetimet satelitore me 7 kanale tv dhe 5 radio. Kjo

kërkesë bëhet me qëllim për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit të sinjaleve duke qenë se sistemi kishte paraqitur problematika. Lista e pajisjeve për të cilat kërkohet suporti janë:

- Mediakind “Ericsson C2” Box System – SN: FLO03224
- Mediakind “Ericsson C2” Box System – SN: FLO03225

- Më datë 21.12.2020, DP i RTSH nxjerr Urdhrin nr. 68 prot. “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Argumentimit të Fondit Limit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor” dhe me përbërje si vijon:

1. A. B. 2. F.Z 3. K.B

- Për përlogaritjen e Fondit Limit, grupi i punës bëri një përzgjedhje prej 3 operatorësh, duke i vlerësuar si operatorë potencialë në treg. Me plotësimin e afatit kohor përfundimtar, iu përgjigjën kërkesës së grupit operatorët: “A.S”, “R shpk” dhe “A.C”. Nga mesatarja e 3 ofertave të operatorëve të mësipërm, vlera totale pa TVSH rezultoi të ishte 15,626,666.68 lekë.

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 68/3, datë 11.02.2021, DP i RTSH urdhëroi kryerjen e prokurimit të procedurës “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor” si procedurë e hapur (Marrëveshje Kuadër). Në të njëjtën datë nxirret dhe Urdhri nr. 68/4 “Për ngritjen e KVO të Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” për objektin “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor” me përbërje si më poshtë:

1. D.K 2. M.A 3. K.B.

- Për hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit u mor Njësia e Prokurimit:

1. G.A 2. F.Z 3. G.N

Njësia e prokurimit, të cilët kanë hartuar dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, ka mbajtur procesverbal më datë 15.02.2021, në të cilin ka argumentuar dhe kriteret e veçanta të vendosura mbi:

- Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit financiare 2018, 2019, 2020 duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 35% e fondit limit.

- Kapacitetin teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

2. a) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015 (Për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

b) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 27001:2013 (Për sigurinë e informacionit).

c) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 20001-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT).

3. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një person të diplomuar në nivel master shkencor në inxhinieri, informatike ose telekomunikacioni.

4. Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e sistemit Mediakind “Ericsson C2” Box System.

Nga auditimi u konstatua se, megjithëse njësia ka patur në grup një specialist të fushës së informatikës, nuk është argumentuar teknikisht përse janë të nevojshme kërkesat mbi kapacitetin teknik, në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.”.

b. Vlerësimi i Ofertave

Me urdhrin e titullarit nr. 68/7, datë 16.02.2021, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, për procedurën e sipërpërmendur, e cila u hap më datë 12.03.2021, ora 10.00.

Pjesëmarrës në këtë procedurë ka qenë vetëm një operator ekonomik:

- OE "T" shpk me ofertë 11,676,000 (njëmbëdhjetë milionë e gjatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh.

Operatori "T" shpk kualifikohet pasi plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta dhe shpallet fitues i procedurës. Ankesa brenda afatit 7-ditor nuk ka patur.

- Në datën 02.04.2021 është mbajtur dhe raporti përmbledhës i procedurës nga ana e KVO. Më datë 14.04.2021 është lidhur kontrata midis AK RTSH dhe Kontraktuesit "T" me objekt "Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor" me afat 36 muaj me vlerë totale 11,676,000 (njëmbëdhjetë milionë e gjatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh ose 14,011,200 (katërmëdhjetë milionë e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë me tvsh në total.

c. Zbatimi i kontratës

- Me urdhrin e titullarit nr. 45, datë 20.05.2022 është urdhëruar ngritja e grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt "Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor" me përbërje: 1. M.M 2. G.N 3. R.V

Nga auditimi konstatohet se operatori ekonomik nuk dërgon raporte mujore periodike mbi mirëmbajtjen e këtij shërbimi. Funkionimi i tij mbikqyret vetëm nga grupi i punës për marrjen në dorëzim i cili harton një procesverbal çdo muaj në momentin e pagesës së faturës nga RTSH, nëse transmetimi i radios dhe programeve TV në platformën DVB-S2 ka qenë i rregullt ose jo. Për çdo problematikë që ka lindur në funksionimin e këtyre pajisjeve, AK dhe Kontraktuesi kanë komunikuar telefonikisht ose nëpërmjet email-it për zgjidhjen e problemit, por Kontraktuesi nuk ka mbajtur raportin mujor me monitorimet përkatëse të ecurisë, KPI-ve apo problematikave të pajisjeve Mediakind Ericsson C2 Box System. Gjithashtu, edhe në kontratën e lidhur midis AK dhe Kontraktorit nuk është përcaktuar shprehimisht dërgimi i raporteve mujore të mirëmbajtjes nga ana e operatorit ekonomik, duke i dhënë, kështu, një fuqi kontraktuale më të madhë këtij të fundit.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

4. Mbi procedurën e prokurimit "Blerje pajisje dhe software (program) për postën elektronike në RTSH":

Tabela : Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë 98339-06-16-2021

1. Urdhër Prokurimi: nr. 26/4, datë 09.06.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike:	4. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit:
2. Fondi Limit (pa TVSh) 5,500,000 lekë	1. F.V	1. F.Z 2. G.H 3. K.B
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar"	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta:	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:
	1. K.S 2. M.A 3. N.M	1. A.B 2. F.Z 3. K.B
8. Data e hapjes së tenderit: 05.07.2021, ora 10.00	9. Operatori fitues: "P.S" shpk me ofertë 5,200,000 (pesë milion e dyqind mijë) lekë pa tvsh.	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 300,000 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 2 (dy)	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP:

		Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 26/20 prot, datë 09.09.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 6,240,000 (gjashtë milionë e dyqind e dyzetë mijë) lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë: 15 ditë
Ndjekësit e kontratës: 1. E.T 2. F.V 3. S.B		

a. Specifikimet teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

- Në datë 11.05.2021, me shkresën nr. 26/2, DP i RTSH urdhëroi ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Argumentimit të Fondit Limit për procedurën me objekt “Blerje pajisje dhe software (program) për postën elektronike në RTSH”, me përbërje:

1. F.Z
2. G.H
3. K.B

- Më datë 28.05.2021 u mbajt procesverbali i argumentimit të fondit limit. Për përlogaritjen e Fondit Limit, grupi i punës bëri një përzgjedhje prej 3 operatorësh, duke i vlerësuar si operatorë potencialë në treg. Me plotësimin e afatit kohor përfundimtar, iu përgjigjën kërkesës së grupit operatorët: “P.S”, “I.S” dhe “ISS”. Nga mesatarja e 3 ofertave të operatorëve të mësipërm, vlera totale pa TVSH rezultoi të ishte 5,500,000 lekë.

- Për hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit u mor Njësia e Prokurimit:

- 1.K.S
2. M.S
3. N.M

Njësia e prokurimit, të cilët kanë hartuar dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, ka mbajtur procesverbal më datë 16.06.2021, në të cilin ka argumentuar dhe kriteret e veçanta të vendosura mbi kapacitetin profesional, ekonomik, financiar dhe teknik si më poshtë:

Mbi kapacitetin profesional të OE:

1. OE ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- 1 specialist të certifikuar CCNA ose ekuivalent
- 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për të instaluar dhe konfiguruar pajisjen Server
- të paktën 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për Windows Server të paktën niveli MCSA ose ekuivalent ,për të vërtetuar stafin e mësipërm, OE duhet të paraqesë:
- Certifikatat përkatëse/transkriptet përkatëse
- Listëpagesat sipas formularit E-sig 025/a sipas legjislacionit në fuqi

- Mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Xhiroja mesatare vjetore për tre vitet e fundit financiarë duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

- Mbi kapacitetin teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, përkatësisht 1,100,000 lekë (një milion e njëqindmijë) pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga prodhuesi për pajisjen Server dhe Softëare (program) për postën elektronike të ofruar.

3. a) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015 (Për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

b) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 27001:2013 (Për sigurinë e informacionit).

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë faqen e katalogut ose broshurës për pajisjet/mallrat dhe software-t që oferton si objekt prokurimi, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të kërkuar në dokumentat e tenderit.

5. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një tabelë të skedës teknike ku të paraqesë për secilin nga mallrat objekt prokurimi të dhënat sipas tabelës së plotësuar si më poshtë: emri prodhuesit/kodi prodhuesit, modeli/emërtimi i katalogut/nr. faqes.

- Më datë 22.06.2021, APP, në kuadër të asistencës që u ofron institucioneve publike në lidhjet me procedurat e shpallura në SPE, i sugjeron RTSH:

▪ Rivlerësimin e kërkesave mbi kapacitetin profesional të OE në fazën e ofertimit në pjesën ku citohet se duhet të sillen certifikatat/transkriptet përkatëse pasi në pikën 1, neni 26 i VKM nr. 285/2021 parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP”*.

▪ Saktësimin e kriterit mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas nenit 43 të VKM 285/2021 ku parashikohet: *“Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse OE arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”* Për sa më sipër, APP sugjeron rihartimin e kriterit duke përcaktuar *“Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se ...% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.”*

▪ Gjithashtu, APP sqaron se kur nga AK konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i DST, përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim, mbështetur në përcaktimet e nenit 75 të LPP, AK nuk duhet të anulohë procedurën, por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila u vihet në dispozicion OE në DST të publikuara në SPE.

- Më datë 28.06.2021 AK harton një shtojcë në DST duke zbatuar sugjerimet e APP mbi kapacitetin profesional dhe ekonomik-financiar të OE, si dhe cakton datën e re të hapjes së procedurës për dorëzimin e ofertave: 05.07.2021, ora 10:00.

b. Vlerësimi i Ofertave

Më datë 05.07.2021, ora 10.00, u bë hapja e procedurës nga anëtarët e KVO.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë dy operatorë ekonomikë:

- OE “I.S” shpk i cili nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.

- “P.S” shpk me ofertë ekonomike me vlerë 5,200,000 (pesë milion e dyqind mijë) lekë.

Operatori “I.S” shpk skualifikohet për arsyet si më poshtë:

- Në kriteret e përgjithshme dhe teknike nuk ka ngarkuar asnjë dokument për Certifikatën e Regjistrimit nga QKB;

- Në fazën e kuotimit nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.

- Oferta e operatorit “P.S” shpk ka rezultuar e suksesshme dhe është njoftuar si fitues më datë 19.07.2021.

- Në datën 03.08.2021 është mbajtur dhe raporti përmbledhës i procedurës nga ana e KVO. Më datë 09.09.2021 është lidhur kontrata midis AK RTSH dhe Kontraktuesit “P.S” shpk me objekt “Blerje pajisje dhe softëare (program) për postën elektronike në RTSH” me afat 15 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës, me vlerë totale 5,200,000 (pesë milionë e dyqind mijë) lekë pa tvsh ose 6,240,000 (gjashtë milionë e dyqind e dyzetë mijë) lekë me tvsh në total.

c. Zbatimi i kontratës

- Me urdhrin e titullarit nr. 452/1, datë 09.09.2021 është përcaktuar komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt “Blerje pajisje dhe software (program) për postën elektronike në RTSH” me përbërje: 1. E.T 2. F.V 3. S.B

- Më datë 24.09.2021 është mbajtur dhe procesverbali mbi verifikimin e mallrave sipas kontratës. Afati kohor për zbatimin e kontratës është respektuar dhe është në përputhje me kohën e përcaktuar në kontratë. Si rezultat, u konfirmua se OE paraqiti në magazinë mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë.

Nga auditimi mbi pagesat e kryera për këtë kontratë me vlerë 6,240,000 (gjashtë milionë e dyqind e dyzetë mijë) lekë me tvsh u konstatua se është kryer pagesa në bankë sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

5. Prokurim i parashikuar dhe realizuar me objekt “Blerje Sistem LTO 9 për nevojat e RTSH”.

Tabela 4: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë REF-42000-09-16-2022

1. Urdhër Prokurimi: nr. 3401 datë 09.09.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: 1. F.V (Kryetar) 2.H.V (anëtare) 3.N.M (anëtare)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1.B.M (Kryetar) 2.K.B (anëtare) 3.J.S (anëtare)
2. Fondi Limit (pa TVSh) 21,748,515.00		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur, e hapur,-mallra, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: 1. F.V (Kryetar) 2.H.C (anëtare) 3.N.M (anëtare)	7. Diferenca me fondin limit: 5,448,515
8. Data e hapjes së tenderit: 10.10.2022	9. Operatori fitues: T Shpk	10. Operatorë të s’kualifikuar: F Shpk
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F Shpk T	12. Operatore të Kualifikuar: T	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Po
14. Ankimimet: Po	15. Përgjigje Ankesës nga AK Po	16. Afati i kontratës do të vazhdojë 45 ditë nga data e nënshkrimit.
17. Lidhja e kontratës: nr.3401/18 dt 29.12.2022	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 19,560,000	19.Ndjekësit e kontratës: 1. G.Z 2. A.N 3. S.B

a. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Me shkresën Nr.565 datë 08.02.2022 Drejtusi i Njesisë Teknike z. H.M i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm me kërkese për hedhjen e materialeve në LTO.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr.63 prot, datë 24.06.2022 Për ngritjen e Komisionit për Argumentimin e Fondit Limit dhe Hartimin e Specifikimeve teknike për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje kasete LTO 9 për nevojat e RTSH-së me Komision të përbërë nga F.V, A.D, H.C.

Me shkresën nr 251/21 Datë 06.09.2022 Relacion mbi argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Sistem LTO-9 për nevojat e Rtsh-së” komisioni pas ftesës për ofertë ka paraqitur ofertat ekonomike:

<i>Përlllogaritja e Fondit Limit bazuar në ofertat e tregut</i>							
<i>Emërtimi</i>	<i>Njësi</i>	<i>Sasi</i>	<i>S</i>	<i>T</i>	<i>T</i>	<i>PS</i>	<i>Mesatare e ofertave</i>
<i>Blerje Sistem LTO-9 për nevojat e RTSH-së & kasetat LTO-9</i>							
<i>Paisje Back-up Tape, Backup</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>14,850,000</i>	<i>36,144,000</i>	<i>19,000,000</i>	<i>17,000,000</i>	<i>21,748,515</i>

<i>kasetat LTO9</i>							
<i>Vlera Totale pa Tvsh</i>							<i>21,748,515</i>
<i>TVSH</i>							<i>4,349,703</i>
<i>Vlera Totale me Tvsh</i>							<i>26,098,218</i>

Me Urdhin e brendshëm Nr 34011 datë 09.09.2022 caktohet fondi limit 21,748,515 Lekë pa TVSH për blerje Sistem LTO 9 për nevojat e RTSH-së.

Me Urdhrin 3401/1 datë 09.09.2022 Krijohet komisioni i Vlerësimit të ofertave i përbërë nga: B.M (Kryetare), K.B, E.B.

Kriteret e veçanta të kualifikimit

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- b) Deshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën ISO 27001 për “Sigurinë e të Dhënave në Rrjet”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet, sistemin dhe softwarin që janë objekt prokurimi, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe motorizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë nga prodhuesi / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e softwarit objekt prokurimi, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar suportin.
- f) Operatori Ekonomik Ofertues duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy)* Inxhinierë / Specialistë (Inxhinier Telekomunikacioni / Elektronik ose Informatikë) në stafin e vet të cilët do të garantojnë shërbimin e ofertuar. Të vërtetohet nëpërmjet diplomës/certifikatës, kontratës individuale të punës të vlefshme në momentin e zhvillimit të tenderit ose të figurojë në listë pagesat e shoqërisë tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Me shkresën nr.3590 datë 26.09.2022 Operatori Ekonomik “S” shpk paraqet ankesën pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në të cilën kërkon që: Të modifikohet afati i ekzekutimit të kontratës, të modifikohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

Pas ankesës nga Operatori Ekonomik me shkresën nr 3400/9 datë 26.09.2023 procedura e prokurimit pezullohet nga Drejtoria Juridike.

Me Urdhrin e brendshëm Nr.125, datë 26.09.2022 ngrihet Komisioni i Shqyrtimit të ankesës i përbërë nga D.D, B.M (Kryetare), J.S

Me shkresën Nr.3590/2 datë 03.10.2022 Komisioni i shqyrtimit të ankesave i drejtohet Drejtorit të përgjithshëm për vendimin në lidhje me ankesën e ardhur nga Operatori Ekonomik. Sipas KSHA, pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik “S” shpk nuk qëndrojnë. Me shkresën nr. 35903/3 datë 03.10.2022 RTSH kryen kthim përgjigjen Operatorit Ekonomik me dijeni KPP-së rreth vendimit të marrë. Me shkresën nr 2092/3 datë 18.10.2022 KPP i drejtohet RTSH dhe Operatorit “SC” me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur për të kryer një seancë

dëgjimore. Me urdhrin 3590/5, datë 18.10.2022, Drejtoria Juridike Përcakton Përfaqësuesit e RTSH për seancën dëgjimore me anëtar: F.V, G.N, H.C. Me shkresën nr 3590/7 datë 21.10.2022, KPP ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën përshkruan ankesat dhe pretendimet e palëve. Me Vendimin Nr.1040/2022 datë 25.10.2022 KPP pranon pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “S” SHPK dhe vendos që RTSH të kryejë modifikimet përkatëse duke e publikuar në shtojcën me modifikimet dhe sqarimet.

Me vendimin Nr.1067/2022 datë 04.11.2022 KPP vendos që RTSH të vazhdojë hapat e mëtejshme me procedurën e prokurimit.

Me Vendim nr 3401/10 datë 10.11.2022 Drejtoria Juridike e RTSH heq nga pezullimi procedurën e Prokurimit.

Me shkresën Nr.4035/7 datë 10.11.2022, RTSH njofton për ndryshimin e dokumentave të tenderit.

Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhrin 3401/4 më datë 19.09.2023, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave që ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, për procedurën e sipërpërmendur. KVO është i përbërë nga B.M, K.B dhe J.S. Në këtë procedurë prokurimi u paraqitën oferta ekonomike si më poshtë:

-Operatori Ekonomik “F” Shpk **17,964,000 Lekë**

-Operatori Ekonomik “T” Shpk me Ofertë **16,300,000 Lekë**

Mbështetur dhe në Ligjin 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, në VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Është kryer klasifikimi përfundimtar më datën 24.11.2022.

KVO vlerëson të vlefshme Ofertën e paraqitur nga “T” shpk dhe të pavlefshme ofertën e paraqitur nga Operatori “F” shpk për arsye se Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Auto deklaratë me anë të së cilës të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëje me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email).

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të operatorit “T” Shpk me NIPT K7.....1F vlerë 163,000,000 Lekë pa TVSH.

Zbatimi i kontratës

Me urdhrin nr 48 datë 06.01.2022 është ngritur grupi i punës i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të mallrave i përbërë nga: G.Z, A.N, S.B.

Me fletë hyrje Nr.49 datë 16.02.2023 është kryer hyrja në magazinë.

Me anë të formularit Urdhër Transferte është paguar shuma 19,560,000 lekë drejt operatorit “T” shpk.

6. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “ Blerje PC kartë rrjeti rrjeti për nevojat e RTSH.

Tabela nr.02: Të dhënat e prokurimit për procedurën me referencë REF-47480-10-26-2022

1. Urdhër Prokurimi: nr. 3929 datë 20.10.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: 1.E.P (Kryetar) 2. M.P anëtare 3. K.B (anëtare)	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: D.D (Kryetar) A.V (anëtar) I.V (anëtar)
2. Fondi Limit 3,207,333 (pa TVSh)		

5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur, e hapur,-mallra, me mjete elektronike”.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: 1. S.B (anëtar) 2.N.M (anëtare) 3. M.P (anëtar)	7. Diferenca me fondin limit 383,633 Lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 08.11.2022	9. Operatori fitues: PS Shpk	10. Operatorë të s’kualifikuar: Nuk ka
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1.PS Shpk 2.A Shpk	12. Operatore të Kualifikuar: 1.P.S Shpk 2.A Shpk	13. Ankimime: jo
14. Lidhja e kontratës: nr. 3929/9 datë 05.12.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh): 3,388,440	16. Afati i kontratës do të vazhdojë 30 ditë nga data e nënshkrimit.
17. Ndjekësit e kontratës: 1. B.M 2. L.M 3. H.K		

b. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Me shkresën nr256/2 datë 01.03.2022 Ngrihet Komisioni i Prokurimit për Procedurat me Vlerë të Vogël për hartimin e relacionit për llogaritjen e vlerës së fondit limit.

Me shkresën Nr. 3340/1 më datë 08.09.2023 drejtorja Juridike i Drejtohet Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit për përcaktimin e specifikimeve teknike të pajisjeve.

Me shkresën nr.3347/1 datë 13.09.2022 Njësia Teknike i drejtohet Drejtorit Të Përgjithshëm për nevojat për blerje pajisjesh dhe shërbimi.

Me shkresën Nr. 3340/2 më datë 16.09.2022 Drejtorja e TI i paraqet Drejtorisë Juridike Specifikimet teknike për pajisjet e kërkuara.

Me shkesën Nr.3347/3 datë 16.09.2022 Njësia Teknike i paraqet Drejtorisë Juridike Specifikimet teknike për kartën e zërit.

Për këtë procedurë prokurimi u caktua fondi Limit **3,207,333 Lekë pa Tvsh dhe 3,848,779 Lekë me TVSh.**

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	PC Workstation	copë	1
2	PC Grafike	copë	1
3	PC Grafike/Montazh	copë	5
4	Audio interface (kartë zëri)	copë	1

Kriteret e veçanta

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes Autorizim nga prodhuesi / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi për artikujt 1,2 dhe 3 (PC Workstation, PC Grafike, PC Grafike/Montazh). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.
- c) Për artikullin e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike), te paraqiten Katalogë/ose/Skedë Teknike të artikullit, ku te përfshihen specifikimet teknike të hollësishme për artikullin e kërkuar (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, te përkthehen në gjuhën shqipe dhe te motorizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Vlerësimi i Ofertave

Me Urdhrin Nr.3929/1 datë 20.10.2023 krijohet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga D.D (Kryetar), A.V (anëtar), I.V Anëtar.

Me proces Verbalin e vlerësimit më datë 14.11.2023 (Pa nr Protokolli)

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët:

OE “P.S” Shpk me Ofertë Ekonomike: **2,823,700 Lekë Pa Tvsh.**

OE “A” Shpk me Ofertë Ekonomike: **3,047,000 Lekë Pa Tvsh.**

Nga shqyrtimi i ofertave ekonomike të paraqitura dhe i dokumentacionit, KVO vlerëson të vlefshme Ofertat e paraqitura.

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të operatorit “P.S” sh.p.k me vlerë financiare **2,823,700** lekë pa TVSh si OE që ka përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në këtë procedurë dhe është me vlerë më të ulët.

Zbatimi i kontratës

Me urdhrin e titullarit nr. 3929/11, datë 06.12.2022 është përcaktuar komisioni për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave për kontratën me objekt “Blerje PC kartë rrjeti për nevojat e RTSH”.

Grupi është i përbërë nga: B.M, L.M, H.K.

Afati kohor për zbatimin e kontratës është respektuar dhe është në përputhje me kohën e përcaktuar në kontratë. Likuidimi i faturës nr 11.04.2022 datë 14.12.2022 me kontratën Nr. 3929/9 datë 05.12.2022 është kryer më 13.01.2023.

7. “Blerje pjesë dhe materiale për pajisje kompjuterike për nevoja të RTSH”. 2022

REF-58715-02-2023

1. Urdhër Prokurimi: nr. 3401 datë 09.09.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: 1.G.Z 2.A.V 3.M.P	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: 1.A.N (Kryetar) 2.Xh.J (anëtar) 3..H.C (anëtare)
2. Fondi Limit (pa TVSh) 3,283,233		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur, me mjete elektronike	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit dhe kriterëve të veçanta: 1.G.Z 2.A.V 3.M.P	7. Diferenca me fondin limit: 795,433 lekë

8. Data e hapjes së tenderit: 23.02.2023	9. Operatori fitues: PS Shpk	10. Operatorë të s'kualifikuar: A.A
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1. A.A 2. P.S 3. I.S	12. Operatore të Kualifikuar: 1. P.S	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Po
14. Ankimimet: Po	15. Përgjigje Ankesës nga AK Po	16. Afati i kontratës do të vazhdojë 14 ditë nga data e nënshkrimit.
17. Lidhja e kontratës: Nr 457/22 datë 1.5.05.2023	18. Vlera e kontratës (pa TVSh): 2,487,800 lekë	19 .Ndjekësit e kontratës: 1. L.M 2. S.B 3. I.K

c. Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Me urdhrin e brendshëm nr 4492 datë 02.12.2022 ngrihet Komisioni për hartimin e fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të Kontratës që po prokurohet.

Kapaciteti teknik:

Dëshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Për artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike), te paraqiten Katalogje/ose/Skedë Teknike/ose broshura të artikujve, ku te përfshihen specifikimet teknike të hollësishme për artikullin e kërkuar (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, te përkthehen në gjuhën shqipe dhe te motorizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuar sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

c) Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë në të cilën të deklarojë se mallrat objekt i procedurës kanë një afat garancie minimalisht 1(një) vjeçar nga momenti i dorëzimit të tyre pranë AK, dhe në rast shpallje fitues duhet të lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci.

Me shkresën Nr. 44/4 datë 03.02.2023 grupi i punës paraqet argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën me objekt “Blerje pjesë materiale dhe pajisje kompjuterike për nevojat RTSH.

Me shkresën Nr. 44/5 më 07.02.2023 Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit i drejtohet Drejtorisë Juridike me kërkesën që procedura e prokurimit të realizohet në formën e marrëveshjes kuadër meqenëse malli i kërkuar cilësohet si mall konsumi.

Me urdhrin e Prokurimit Nr. 457 datë 10.02.2023 Sektori i Planifikimit dhe Prokurimit Publik urdhëron kryerjen e prokurimit me mjete elektronike me fond Limit 3,283,233 Lekë pa Tsbh për periudhën deri më 31.12.2023.

Me urdhrin Nr. 457/1 datë 10.02.2023 Sektori i Planifikimit dhe Prokurimit Publik krijon Komisionin e Vlerësimit të ofertave të përbërë nga A.N (Kryetar) , Xh.J (anëtar) , H.C (anëtare). Pas përfundimit të fazës së dorëzimit të ofertave në datën 23.02.2023 KVO kryen hapjen e ofertave në sistemin elektronik të APP.

Në këtë procedurë morën pjesë:

1. Operatori Ekonomik “AA” shpk me Ofertë **2,117,800 Lekë pa Tvsh**
2. Operatori Ekonomik “P.S” Shpk me Ofertë **2,487,800 Lekë pa Tvsh**
3. Operatori Ekonomik “I.S” **2,700,000 Lekë pa Tvsh**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorëve KVO vlerësoi që Operatorët Ekonomik “A.A”, “P.S” shpk dhe I.B.S. plotësojnë kriteret e vendosura në DST duke e konsideruar ofertën të vlefshme.

Me shkresën Nr.457/4 datë 09.03.2023 Sektori i Prokurimeve njofton Operatorët pjesëmarrës dhe Operatorin fitues paraprak të procedurës duke u bazuar në ofertën më të favorshme në çmim.

Me formularin 457/5, datë 17.03.2023 Operatori Ekonomik P.S Shpk paraqet ankesë pranë Autoritetit Kontraktor. Sipas OE PS, AK ka kualifikuar ofertën e Operatorit A.A pa përmbushur kriteret e kërkuara.

Me shkresën nr.457/6, datë 17.03.2023, Sektori i Planifikimit dhe i prokurimeve vendos të pezullojë procedurën për shqyrtimin e ankesës së OE P.S Shpk.

Me urdhrin e brendshëm Nr.457/8 datë 23.03.2023 krijohet Komisioni i Shqyrtimit të ankesës i përbërë nga: D.D (Kryetar), S.B (anëtar), M.K (anëtar).

Me shkresën nr.457/9, datë 24.03.2023, KSHA argumenton se OE ankimes duhet ta shoqërojë ankesën me prova, ankesa duhet të plotësohet dhe të paraqitet pranë AK.

Me shkresën nr. 575/6, datë 06.04.2023 KPP dërgon Vendimin në RTSH. Sipas KPP ankesa e paraqitur nga OE PS shpk qëndron dhe vendos që AK të anulojë vendimin e KVO mbi kualifikimin e operatorit A.A duke e skualifikuar këtë operator.

Me shkresën nr. 457/11, datë 07.04.2023 Drejtoria e Planifikimit dhe prokurimeve vendos heqjen e pezullimit të procedurës.

Autoriteti Kontraktor anulon Vendimin e KVO për kualifikimin e Operatorit A.A pasi nuk plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.

Pas renditjes përfundimtare Operatori PS shpk renditet i pari me Ofertë 2,487,800 Lekë pa Tvsh.

Marrja në dorëzim

Me urdhrin nr. 1057/27, datë 17.05.2023 Drejtoria juridike krijon grupin e punës për ndjekjen e kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit të përbërë nga: L.M, S.B, I.K.

Me procesverbalin nr.457/ 29, datë 25.05.2022 grupi i punës merr në dorëzim materialet dhe pjesët kompjuterike.

Më 12 Qershor 2023 RTSH likuidon faturën nr. 4132/2023 me vlerë 2,182,800 referuar kontratës nr. 457/22, datë 15.05.2023.

1.Titulli i Gjetjes:	Mungesë e raporteve periodike të mirëmbajtjes së pajisjes.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor”, për vitin 2021, në kontratën e lidhur midis Autoriteti Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik fitues nuk është përcaktuar shprehimisht dërgimi i raporteve mujore të mirëmbajtjes nga ana e operatorit ekonomik. Funkcionimi i sistemit mbikëqyret vetëm nga grupi i punës për marrjen në dorëzim i cili harton një procesverbal çdo muaj në momentin e pagesës së faturës nga RTSH, ndërsa operatorit ekonomik nuk mban asnjë raport mujor

	për monitorimet përkatëse të ecurisë, KPI-ve apo problematikave të pajisjeve Mediakind Ericsson C2 Box System. Pra, detyrën e OE e ka kryer grupi i marrjes në dorëzim, i cili, njëkohësisht, merr në dorëzim mbikëqyrjen që ka bërë vetë.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar.
Ndikimi/efekti:	Risk në zbatimin e kontratës.
Shkaku:	Mungesa e parashikimit eksplicit në kontratë për kontraktuesin që të dërgojë raportet mujore të mirëmbajtjes së sistemit.
Rëndësia:	E mesme.
1.1Rekomandimi:	RTSH të marrë masa që në hartimin e kontratave për mirëmbajtjen e sistemeve në të ardhmen, të mirëpërcaktojë të drejtat dhe detyrimet e sëcilës palë me qëllim matjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të kontraktuara.

2. Titulli i Gjetjes:	Mungesë e urdhrit për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit të prokuruar.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se titullari i Autoritetit Kontraktor, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje kompjuter për RTSH”, për vitin 2021, nuk ka ngritur urdhër për përcaktimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit të prokuruar. Malli është marrë në dorëzim nga vetë Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.
Ndikimi/efekti:	Risk në marrjen në dorëzim të mallit të prokuruar sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë, si dhe në zbatimin e kontratës.
Shkaku:	Mos nxjerrja nga ana e titullarit të institucionit të Urdhrit për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit të prokuruar; Mosrespektimi i kuadrit ligjor për Prokurimin Publik për mbikëqyrjen e kontratës dhe akteve ligjore për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i RTSH të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara, në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara dhe si detyrë funksionale që i buron nga roli si titullar i Autoritetit Kontraktor.

3.Titulli i Gjetjes:	Nga auditimi u konstatua se në procedurën e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor”, për vitin 2021, dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se në procedurën e audituar “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor” viti 2021, dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh.
Kriteri:	Ligji 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik, neni 99; Vendimi Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, pika 2, shkronja k) dhe neni 84; Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, Neni 36 “Arkivat e numerizuar dhe Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e dokumentacioneve sipas përcaktimeve ligjore sjell mosmatjen e cilësisë së shërbimeve të përfituara nga investimet dhe ndërprerjes së gjurmës së auditimit.
Shkaku:	Moszbatimi i dispozitave ligjore proceduriale
Rëndësia:	E mesme.
3.1Rekomandimi:	RTSH, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe personat e autorizuar për hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, të marrin masa që për procedurat që do të zhvillohen në vijimësi të përmbushin të gjitha përcaktimet e dispozitave ligjore dhe proceduriale në fushën e arkivimit të dosjeve.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Aktkonstatimi nr.2, datë 13.11.2023, protokolluar në RTSH me nr. 2006/2, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 12-31 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

3. Mbi Auditimin e Sistemeve dhe Sigurisë së Informacionit në RTSH

Siguria e informacionit është e rëndësishme për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

➤ *Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit*

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktivitetëve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

RTSH kryen një shërbim publik në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe aktivitetëve multimedia (internet, OTT, IPTV), duke përdorur edhe teknologjitë e reja të transmetimeve.

RTSH-ja kryen këto shërbime për vete dhe për të tretët:

- a) prodhon në formatin analog dhe digjital programe për vete dhe për të tretët;
- b) prodhon e transmeton mesazhe tregtare, reklama dhe shërbime reklamash në programet audio dhe/ose audiovizive;
- c) organizon marketingun e filmave televizive, të programeve audio dhe audiovizive dhe të regjistrimeve muzikore në tregjet vendase dhe të huaja;
- ç) organizon blerjen, shitjen, shkëmbimin e dhënien me qira të filmave dhe videofilmave, si dhe të programeve audio dhe/ose audiovizive;
- d) prodhon me porosi nga shfrytëzimi i arkivit të RTSH-së;
- dh) vë në dispozicion, kundrejt pagesës, kapacitetet e lira të prodhimit e të transmetimit për të tretët, në formë shërbimesh, kundrejt detyrimeve kontraktore;
- e) kryen shërbime teleteksti;
- ë) ka të drejtë të botojë revista dhe materiale të ndryshme propagandistike, për promovimin e programeve audio dhe/ose audiovizive, si dhe libra profesionalë dhe të gjinive të tjera me interes publik.

Shërbimet teknike të RTSH-së konsistojnë në:

- mirëmbajtja dhe operimi i objekteve dhe pajisjeve të destinuara për marrjen, shkëmbimin, shpërndarjen dhe transmetimin e programeve të prodhuara nga RTSH-ja, duke përdorur teknologji analoge dhe digjitale;
- sigurimi i shikimit dhe dëgjimit të programeve të transmetuara nga RTSH-ja, duke bërë të mundur edhe transmetimin e programeve të operatorëve të tjerë;
- modernizimi teknologjik dhe rregullimi i rrjetit të transmetimit, sipas standardeve të vendeve europiane;
- sigurimi i shikimit dhe dëgjimit të programeve të RTSH-së në zonat kufitare, të banuara nga minoriteti kombëtar shqiptar, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe;
- aktivitetet e operatorëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komunikimit, duke përdorur teknologji analoge dhe digjitale.

Përveç Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, e cila meret me mirëmbajtjen e pajisjeve dhe programeve kompjuterike që RTSH disponon, gjithashtu Njësia Teknike e cila është pjesë përbërëse e strukturës së RTSH kryen detyra dhe veprime të cilat lidhen me operacionet e IT, si dhe pjesën teknologjike që RTSH disponon. Kjo strukturë ka në përdorim dhe përgjigjet për disa sisteme kryesore të RTSH konkretisht për: Regjistrim-Transmetimin, Linjat e transmetimit, sistemi elektrik, Teknikës TV, Teknik Rregjistrimi & Montazh, Sudio Lëvizëse, Teknik Zëri, Teknik Radio, Transkodimi, Teknik Profilaktik etj.

Sistemet/aplikacione të Teknologjisë së Informacionit në RTSH

Arkivimi digjital i materialeve dhe menaxhimi i aseteve të RTSH-së

MAM: Sistemi MAM (Media Asset Management) konsiderohet si një ndër hallkat më kryesore të strukturës teknologjike në një radio-televizion modern. Sistemi multifunksional modern për menaxhimin e aseteve multimedia (MAM), është sistem, i cili është si qendër për të ndërlidhur të

gjitha nënsistemet e tjera që ngrihen për playout, livestream, VOD (platforma OTT¹) etj. Sistemi MAM është një komponent i cili ndihmon në menaxhimin e efektshëm të resurseve audiovizuale, duke përfshirë video, audio, dhe materiale të tjera të lidhura me media. Struktura MAM përbëhet nga disa software që zgjidhin role të ndryshme, si dhe nga një strukturë hardware që plotëson nevojat specifike të platformës MAM. Platforma MAM shërben si shtylla kurrizore për të tjerë elementë të rëndësishëm të një studioje televizive, duke filluar që nga sistemi i playout, sistemi i shërbimit on-demand në web, sistemi informativ në web, sistemet e apps-eve për device ndër më të ndryshmit, si dhe për platformën Over-the-Top (OTT).

Figura nr. 1: Pamje nga ndërfaqja e sistemit MAM



Burimi: RTSH, sistemi MAM

Sistemi MAM aktualisht në RTSH përdoret për arkiv dhe transmetim, për kanalet të automatizuara dhe të integruara në sistemin MAM. Sipas “Rregullores së workflow të punës për file-in dixhital në RTSH” miratuar me vendim nr. 30, datë 14.11.2022 nga këshilli drejtues, sistemi MAM ka funksionuar si më poshtë:

Çdo material që hidhet në sistemin MAM krijon një aset (audio ose video).

Fushat që plotësohen për çdo aset janë:

1. Tipi;
2. Kodi;
3. Titulli;
4. Vendi i prodhimit;
5. Data e prodhimit;
6. Zhanri ose zhanret (nëse ka disa);
7. Informacion mbi përmbajtjen e materialit;
8. Skenari dhe skaleta e materialit;
9. Grupi realizues (autori, operatori, regjisori, montazhi, etj.);
10. Sponsori (nëse ka);
11. Baza muzikore (nëse është përdorur);
12. Vendorsja e personazheve publikë (të cilëve sistemi u referohet si “artist”), kur ata ekzistojnë, thjesht shtohen në aset. Në rastin kur nuk ekzistojnë, duhet të krijohen.
13. “Metadata/Epg Language 1”, duhet të plotësohet me informacion të përshtatshëm për shfaqjen e përshkrimit të shkurtër të EPG (Electronic Program Guide), me maksimumi 250 karaktere.
14. “Metadata/Story”, duhet të plotësohet me informacion të përshtatshëm për shfaqjen e përshkrimit të gjatë të EPG, me maksimumi 450 karaktere.
15. Fushat e nënmenusë së menaxhimit të të drejtave të aseteve për të gjithë produktet e blera, spotet promovuese dhe spotet e marketingut, janë:
 - Data kur ky aset është i mundur të transmetohet;

¹ "Over the top" (OTT) është platforma që mundëson arritjen e publikut nëpërmjet internetit në të gjitha llojet e pajisjeve, duke filluar nga kompjuteri i tavolinës, tabletët, celularët e deri tek aplikimet e Smart TV-ve të ndryshëm, konsola lojërash etj.

- Data kur këtij asemi i skadon afati i transmetimit;
- Ditët kur ky material duhet të transmetohet;
- Shpeshësinë e transmetimit;
- Numrin e herëve që lejohet të transmetohet.

Informacion sesi është rrjedha e informacionit në MAM:



1. “Burim i materialeve multimediale” është origjina e file-it dixhital ku klasifikohen të gjithë hyrjet e materialeve audio video në RTSH, materiale të prodhuara nga RTSH apo edhe palë të treta, të cilat mund të jenë të blera apo të dhuruara.
2. “Përpunim i materialeve multimediale” janë të gjitha proceset e montazhit dhe faqosjes grafike të materialeve në file dixhital.
3. “Menaxhim i materialeve multimediale” janë të gjithë proceset që kryhen për inventarizimin, ingest²-in dhe katalogimin e tyre në sistem.
4. “Transmetim i materialeve multimediale” është ofrimi i shërbimit të programeve audiovizive për dëgjuesit dhe/ose shikuesit.
5. “Arkivim i materialeve multimediale” është procesi final dhe i fundit për rrugëtimin e file-it dixhital, ku materialet multimediale ruhen sipas standarteve të përcaktuara dhe vendosen në dispozicion sipas kërkesave.

Materialet që krijohen dhe ruhen nëpërmjet sistemit MAM janë kryesisht:

- Lajmet e ditës;
- Produkte audio vizive që prodhohen nga Njësia e Lajmeve dhe Emisioneve Tematike;
- Lajmet e ditës të kanalit RTSH Sport;
- Produkte televizive Talk Show, biseda etj që prodhohen nga redaksia e RTSH Sport;
- Produksionet e prodhuara nga Njësia e Programeve;
- Seanca Plenare të Parlamentit Shqiptar dhe Komisionet e Kuvendit;
- Produkte Televizive që prodhohen në RTSH nga stafi i jashtëm (Projekte);
- Programet e kanaleve të Radios.

Për secilën nga materialet procesi i ingestit të file-ve dhe kontrolli i kualitetit kryhet nga Sektori i Transkoding dhe Kontrollit të Kualitetit dhe katalogimi i aseteve për secilin tip kryhet nga redaktorët e Drejtorisë së Arkivit.

Sistemi MAM përdoret kryesisht nga gazetarë, redaktorët për pjesën e transmetimit dhe nga specialistët e arkivit për pjesën e arkivës. Punonjësist të cilët përdorin sistemin MAM menaxhohen nga Domain Controlleri i Active Directory, për të cilin ka një organizational unit në Active Directory e emërtuar -> Etere. Nga auditimi konstatohet se për sistemin MAM, RTSH nuk ka disponon asnjë akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të sistemit në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve. Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemit MAM aktualisht realizohet nga përgjegjësi i Platformës Tokësore dhe Satelitore pjesë e Njësisë Teknike, detyrë kjo e atribuar pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të RTSH-ës. Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email nga

² Proceset/materialet që janë duke ardhur në sistem

Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Administratori i sistemit dhe detyrat përkatëse të tij nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga organet drejtuese të RTSH, ku të jenë emëruar zyrtarisht Administratorë për administrimin e sistemit për të ushtruar atributet e përcaktuara sipas funksioneve të tij dhe të gjitha detyrat mbi administrimin e sistemit.


Nga auditimi mbi sistemin MAM, u konstatua se:

- Për një periudhë 1 vjeçare është pa mirëmbajtje.
- RTSH ka patur 2 specialistë të certifikuar për përdorimin e sistemit MAM, të cilët i kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me RTSH dhe aktualisht sistemi MAM nuk menaxhohet dhe administrohet nga asnjë punonjës i autorizuar. Në kushtet aktuale që ndodhet ky sistem dhe mënyra sesi menaxhohet, rrezikon ndërprerjen dhe e bënë të pamundur për ta rikthyer sistemin në gjendjen fillestare.
- Sistemi MAM nuk është shfrytëzuar dhe nuk është përdorur nga RTSH si një sistem informatik i menaxhimit të aseteve Multimediale, me qëllim ndërlidhjen dhe shkëmbimin e informacioneve të të gjitha nënsistemeve të tjera qoftë për ployout, livestream, VOD (platforma OTT) etj.

Sistemi QSAN

Sistemi QSAN është në përdorim që në korrik të vitit 2023, i cili ka zëvendëuar sistemin MAM dhe përdoret për ruajtjen dhe transmetimin e materialeve që RTSH prodhon. Materialet e këtij sistemi janë të organizuara në File Sharing të ndara sipas kategorive. Montazhi me anë të sistemit Sorage të Montazheve realizohet montimin e çdo materiali bruto i cili përgatitet për transmetim dhe ruhet në sistemin QSAN. Materialet merren nga sistemi QSAN dhe nëpërmjet softit **Playbee** bëhet transmetimi i tyre.

Figura nr. 2: Pamje nga ndërfaqja kryesore e sistemit QSAN




Burimi: RTSH, sistemi QSAN

Nga auditimi konstatohet se, për sistemin QSAN nuk disponohet një workflow i mirëfilltë si dhe një rregullore mbi përdorimin e sistemit. Sistemi administrohet nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, pa një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e sistemit dhe përdoruesve të tij. Gjithashtu konstatohet se, për sistemin QSAN nuk disponohet një rregullore në lidhje me arkivimin e materialeve në sistem, qoftë ato në storage dhe ato në arkivë

offline. Materialet ruhen në 2 vende dhe nga 2 herë për të njëjtin material, qoftë dhe materialet bruto të pa përpunuara, duke zënë një kapacitet të konsiderueshëm në storage të sistemit.


Figura nr. 3: Përdoruesit e teknologjisë QSAN

Materialet në QSAN janë në një File Sharing të ndara me kategori të ndryshme sipas përdoruesve për montazhin, transmetimin, capture, marketingun, redaktimin, kryeredaktor, transkodimin, playout, programacionin, promocioni, radioarkiv dhe emisioni.



Nga auditimi konstatohet se, ky sistem është instaluar në datë 06.07.2023 me një hapsirë storage 573 TB dhe për një periudhë të shkurtër kapaciteti storage i QSAN ka arritur në 30%, Duke parë ritmet e punës së përditshme të materialeve të cilat përpunohen dhe ruhen, kapaciteti storage i instaluar shumë shpejt do të ezaurohet duke rrishtuar funksionimin e sistemit në të ardhmen.

Figura nr. 4: Pamje nga ndërfaqja e sistemit QSAN në lidhje me kapacitetin storage




Burimi: RTSH, sistemi QSAN

Sistemi EPG

EPG: "Electronic Program Guide" (Udhëzuesi Elektronik i Programeve) është një shërbim i cili mundëson informimin e shikuesve në Shqipëri dhe në të gjithë territorin e Europës me programet dhe emisionet e RTSH-së, oraret e fillimit të emisioneve, planifikimin e shikimit të një programi të caktuar, regjistrimin e tij dhe shikimin në një kohë të mëvonshme. Nëpërmjet këtij sistemi realizohet: Shfaqja e orareve të programeve, si dhe informacion i detajuar mbi programet. Përveç titullit të programit është edhe një përmbledhje (sinops), ose koment i shkurtër dhe një i gjatë për secilin program. Që prej 31 gushtit 2017 rrjeti i RTSH-së filloi ofrimin e këtij shërbimi, jo vetëm për ata që kanë një televizor të ri apo një digitalbox për televizorët e vjetër, por edhe për këdo që ka një smart phone.

Të gjitha kanalet e rrjetit të RTSH-së kanë bazë të dhënash më vete për filmat shqiptarë, filmat e huaj dhe dokumentarët e huaj. Secili nga redaktorët e kanaleve bashkëvepron për të ndërtuar rrjetin e EPG-së, duke përcaktuar të gjitha informacionet e nevojshme për secilin nga programet që transmetohet në kohë reale. EPG-ja në RTSH, përditëson e pasuron çdo ditë bazën e vet të të dhënave, jo vetëm me programet e reja, por edhe me ato arkiv që kalojnë së fundmi në transmetim.

Figura nr. 5: Pamje nga ndërfaqja kryesore e sistemit EPG



Burimi: RTSH, sistemi EPG

Nga auditimi mbi sistemin EPG, u konstatua se:

- ky sistem në RTSH administrohet nga Drejtorja e Teknologjisë dhe Informacionit, pa një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e sistemit, në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e sistemit dhe përdoruesve të sistemit;
- aktualisht serveri i këtij sistemi është jashtë funksionit dhe është migruar në një workstation model z820;
- për këtë sistem nuk disponohet workflow i mirëfilltë në lidhje me këtë sistem;
- ka problematika me aksesimin e database MySQL dhe SQL;
- dokumenti epg.exe kryen fshirje automatike si dhe ka problem me njohjen e karaktereve si për shëmbull: “ç”, “ë”, gjë kjo e cila vështirëson procesin e punës së këtij sistemi dhe nuk bënë të mundur mbylljen e tagut <desc> description (përshkrimi) </desc>;
- sistemi ka problematika në kod duke mos realizuar mbylljen e kodimit, çka sjell mos ofrimin e shërbimit dhe arritjen e qëllimit të këtij sistemi;
- nuk sinkronizohen materialet të cilat hidhen nga specialistë e programacionit me datën, orën sipas formatit të programit me atë të sistemit;
- specialistët e Drejtorisë të Teknologjisë dhe Informacionit bëjnë dublim të punës duke i hedhur manualisht me dorë të gjithë informacionin për secilin nga programet që do transmetohet;
- Windows Storage Server 2012 i përdorur nuk është Aktiv duke sjellë riskun e ekspozimit ndaj dështimit dhe hakërimit;
- pajisja e back up për këtë sistem e cila ndodhet fizikisht në Server Room është jashtë funksionit.

Nga auditimi mbi politikat e sigurisë së përdoruesve të sistemeve aktuale që RTSH përdor, konstatohet se për sistemin EPG fjalëkalimi për administratorin nuk është ndryshuar dhe pse personeli dhe stafi i IT është ndryshuar ndër vite, fjalkalimet janë trashëguar nga një punonjës tek tjetri pa u përditësuar duke sjellë risk në akses të paautorizuar. Gjithashtu u konstatua se:

- për sistemet kryesore që RTSH përdor nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK5 me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.


RTSH disponon disa sisteme storage si:

- Isilion Data Storage Cluster, i cili është një sistem storage egzistues në RTSH me qëllim arkivimin e materialeve që ka prodhuar RTSH ndër vite. Ky sistem është storage i sitemit MAM.
- Storeeasy, sistem storage për ruajtjen e materialeve e cila është përdorur përpara sistemit MAM dhe sistemit QSAN.

Në RTSH sistemi storage është shpërndarë në një formë të tillë që çdo departament ka hapësirë të përcaktuar dhe jo vetem logjikisht të ndarë, por dhe fizikisht, për të ulur rriskun e mbingarkesës së serverave duke qënë se dhe playout dhe capture punojnë të bazuar në storage dhe local në varësi te hapësirës dhe materialit.

Duke qënë se dhe fluksi i prodhimit është rritur ndjeshëm dhe është gjithmon në rritje është vënë re vështirësi kohët e fundit pasi storage po aksesohen nga 2 – 3 departamente njëherësh. Nga auditimi u konstatua se, storage i Isilon Data Storage me një hapsirë storage rreth 912.55 TB ku ruhen të gjitha materialet multimediale online të ruajtura ndër vite ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit të mundshëm për ruajtjen e materialeve arkivore.


Figura nr. 4: Pamje nga ndërfaqja e sistemit storage Isilion në lidhje me kapacitetin storage




Burimi: RTSH

Nga auditimi konstatohet se sistemi Storeeasy me një hapsirë storage 34.7 TB nuk është më në përdorim nga RTSH pasi ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit storage.

Figura nr. 5: Pamje në lidhje me kapacitetin storage të sistemit Storeeasy



Materialet e saj nuk janë bërë backup në sistemin LTO (back up offline) dhe ekziston si sistem vetëm në rast se duhet për tu përdorur ndonjë material që është në sistem. Gjithashtu, konstatohet se antivirusi është out of date dhe nuk janë bërë update-et e fundit, gjë e cila riskon moskthimin në gjendje të mëparshme dhe humbjen e materialeve të ruajtura në këtë sistem.



Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se:

- nuk disponohet Workflow apo Diagramë të qarkullimit të informacionit për secilin sistem në RTSH;
- nuk u administrua asnjë informacion se çfarë ndodh me menaxhimin e rrjetit DATA në të gjithë rrjetin e RTSH;
- për të gjitha sistemet që RTSH ka në përdorim nuk disponohet një manual përdorimi për përdoruesit e sistemit;
- nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e logeve;
- nuk disponon akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) Institucioni duhet të përcaktojë një rregullore të shkruar për menaxhimin e log-eve sipas kërkesave të institucionit. Kjo rregullore duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

➤ **Procedura e backup-it**

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

LTO system (storage offline): Sistemi LTO (Linear-Tape-Open) është një sistem i përdorur në RTSH për menaxhimin dhe ruajtjen e materialit audiovizual (back up offline). Ky sistem ka një

rol kyç në operacionet e RTSH dhe realizon: Ruajtjen e arkivave, menaxhimi i arkivave, si dhe përdorimi për rimontimin dhe restaurimin e arkivave.

Sistemi LTO përbëhet nga:

1. Server (Supermicro Super Server SYS-220U-TNR);
2. Pajisje Backup Tape (Overland Tandberg NEOs T24 2u/24-slot/1 – LTOP FC + 2 x DRVIE, LTO9HH FC);
3. Programi Backup (software)-(Veeam Backup & Replication);
4. Kasetat LTO (9 Overland Tanberg LTO – 9 Data Cartridge, 18TB/25TB).

Nëpërmjet këtij softi bëhet backup nga storage ekzistues Isilon Data Storage Cluster drejtpërdrejtë në kasete. Materialet që ndodhen në storage e RTSH kopjohen edhe në dy kopje arkive offline (LTO, HDD në varësi të zgjidhjes). Aktualisht janë kopjuar offline 246T dhe janë në process online 393,6T.

Nga auditimi u konstatua se:

- procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RTSH. Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to. Administrimi i këtyretributeve individualisht dhe pa autorizim, nuk jep siguri të arsyeshme për kryerjen e tyre sipas praktikave më të mira;
- aktualisht nëpërmjet këtij sistemi po bëhet backup vetëm Isilon Data Storage, dhe asnjë nga sistemet e tjera si Storeeasy apo sistemi aktual QSAN nuk është bërë backup;
- për Active Directory nuk bëhet back up, duke riskuar mundësimin e rikthimit të të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave;
- backup i mail-it kryhet manualisht, në formë incremental;
- për sistemin MAM nuk disponohet një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center), çka përbën një risk serioz për ndërprerjen e shërbimeve dhe risk për vazhdimësinë e punës, realizohet vetëm back up offline me anë të sistemit LTO, ku materialet bëhen restore vetëm nëpërmjet kasetave LTO.


➤ *Active Directory*

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se RTSH për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet ka në përdorim “Active Directory”, Windows Server 2012 R2. Administratorët që përdorin Active Directory është i gjithë stafi i Drejtorisë IT.

Nga auditimi i Active Directory u konstatua se:


- Windows Server 12 R2 i përdorur për Active Directory nuk është Aktiv duke sjellur ekspozuar ndaj dështimit dhe hakerimit;
- Nuk ka të instaluar antivirus;
- Nuk janë bërë përditësimet, e fundit, e cila riskon moskthimin në gjendje të mëparshme të Active Directory Domain Services;
- Detyra e Administratorit të bazës së të dhënave të Active Directory nuk i janë atribuar me anë të shkresës zyrtare nga strukturat drejtuese të RTSH asnjë specialisti të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

Figura nr. 6: Informacion mbi Windows Server 2012R2



Burimi: Grupi i Auditimit, AD RTSH

Figura nr. 7: Informacion mbi Windows Update




Burimi: Grupi i Auditimit, AD RTSH

Nga auditimi i userave në Active Directory u konstatua se:

- ka punonjës të cilët janë në strukturën e RTSH dhe nuk kanë user në Active Directory;
- ekzistojnë usera të cilët nuk janë më punonjës në RTSH dhe janë aktiv;
- ekzistojnë Njësi Organizative në sistem të cilat janë të pa emërtuara dhe janë me emrin -> Unkown;
- ekzistojnë usera të cilët janë të pa identifikueshëm me emra “test”, “usrbms”, “usrdm”, “usrtx” si dhe shumë raste të tjera të cilat sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistemet dhe në rrjetin e RTSH, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.


Figura nr. 8: Politikat e sigurisë së fjalëkalimeve në Active Directory



Burimi: Grupi i Auditimit, AD RTSH


Nga auditimi u konstatua se konfigurimet e Active Directory janë të konfiguruar by default dhe nuk janë të konfiguruar në përputhje me standardet me të mira. Këto politika të sigurisë konfigurohen sipas rëndësisë që i kushtohet këtyre elementëve, në mënyrë që të rritet niveli i sigurisë së aksesit.

Figura nr. 9: Politikat e sigurisë në Active Directory



Nga auditimi mbi Advanced Audit Policy Configuration Settings u konstatua se konfigurimet nuk janë në përputhje me praktikat më të mira, duke rritur riskun që ngjarjet e sigurisë nuk mund të përditësohen ose nuk do të mund të ndiqen sepse nuk ka një regjistër (log).

Figura nr.10: Të dhëna mbi Advanced Audit Policy Configuration Settings



Burimi: Grupi i Auditimit, AD RTSH


Disa nga risqet që vijnë si rezultat i mos konfigurimeve të duhura dhe default i Active Directory:

- Ekziston rreziku i mos menaxhimit të politikave që mund t'i lejojë përdoruesit të marrin shumë të drejta;
- Rreziku që politikat e fjalëkalimit nuk janë në përputhje me kërkesat e institucionit ose praktikat më të mira. Kjo mund ta bëjë më të lehtë për personat e paautorizuar qasjen në rrjet dhe sisteme;
- Fjalëkalimet që nuk skadojnë kurrë mund të rezultojnë në akses të paautorizuar. Ky është veçanërisht një rrezik nëse ka llogari të përbashkëta përdoruesish ose llogari të sistemit me privilegje administratori. Kështu, ish-punonjësit mund të abuzojnë me këto të drejta;
- Llogaria e një përdoruesi me një fjalëkalim bosh mund të rezultojë në akses të paautorizuar; etj

Me anë të vendimit nr. 13, datë 28.03.2023 të Këshillit Drejtues të RTSH është marrë vendimi për mbylljen e kanaleve TV të RTSH, konkretisht: RTSH Agro, RTSH Plus dhe RTSH 3.

Nga auditimi në Active Directory konstatohet se, kanalet RTSH Agro dhe RTSH 3 ekzistojnë si Organizational Unit dhe kanë usera të cilët janë ende aktive, ky fakt mbart një risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre.

Figura nr. 11: Printscreen i userave aktiv të kanalit RTSH Agro dhe RTSH 3 në Active Directory



Burimi: Grupi i Auditimit, AD RTSH

➤ **Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat**

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhurnimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar që ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit. Vazhdueshmëria a biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje. Auditimi mbi ofrimin e Vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve, u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, risqeve të identifikuara dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je: “Çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbimit të informacionit për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave”. Në këtë VKM cilësohet gjithashtu edhe dokumentimi i politikave mbi planin e vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, si dhe të bëhet i mundur evidentimi i sistemeve të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24/7.

Nga auditimi u konstatua se, RTSH, pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për rimëkëmbjen e infrastrukturës teknologjike pas një katastrofe natyrore ose tjetër me përdorimin e sistemit LTO, nuk disponohen një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center) si dhe nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

➤ **Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet**

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv. Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e


dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike. Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit. Grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të IT në RTSH, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në RTSH.

Për funksionimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në RTSH janë në funksionim dy dhomë serverash, një Server Room në të cilën është lokalizuar e gjithë infrastruktura Hardware/Software/Network e Njesisë Teknike dhe një Server Room në të cilën janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ke që RTSH disponon.

Nga auditimi u konstatua se, dhoma e serverëve në të cilën është lokalizuar e gjithë infrastruktura Hardware/Software/Network e Njesisë Teknike nuk përmbush asnjë nga kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), më konkretisht:

- Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuara;
- Nuk ka sistem kondicionimi, ftofja e ambientit realizohej me freskuse;
- Ambienti ku është lokalizuar dhoma e serverëve është i ndërtuar me dyer xhami, faktor i cili ul sigurinë për në dhomën e serverëve;
- Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik.

Figura nr.12: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve ku është lokalizuar e gjithë infrastruktura Hardware/Software/Network e Njesisë Teknike.



Burimi: Grupi i Auditimit

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave ku janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ke që RTSH disponon e cila plotëson disa nga parametrat TIK të përcaktuara nga AKSHI për ndërtimin e dhomës së Serverave, gjithashtu u konstatuan disa problematika, konkretisht si më poshtë:

- Nga auditimi i procedurës së administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe

dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një akt rregullativ të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje-dalje të personave të paautorizuar. Në dhomën e serverave ka akses i gjithë stafi i Drejtorisë të Teknologjisë dhe informacionit dhe një pjesë e punonjësve nga njësia teknike dhe nga sektori elektrikës, të cilët nuk janë të autorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TI-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës;

- Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, etj) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj;
- Gjenden rack të cilët nuk janë në përdorim si dhe nuk kanë asnjë pajisje elektronike dhe elektrike të instaluar në to;
- Sistemi i kondicionimit përbëhet nga 4 kondicioner, nga të cilët 2 prej tyre janë funksional dhe 2 janë në alert (alarm), duke ndikuar negativisht në mbajtjen e parametrave optimal në ftohjen e duhur të serverave.

Figura nr.13: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve ku janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ke që RTSH disponon.




Burimi: Grupi i Auditimit

Auditimi mbi pajisjet dhe infrastruktura e networkut

Infrastruktura e shërbimeve të përgjithshme në RTSH përbëhet nga:

- Shërbimi i Internetit;
- Shërbimet e Postës Elektronike;
- Active Directory/Domain Controller File Server (kryesisht dedikuar Njesisë së Progmave Tematike dhe Lajmeve, si dhe Drejtorisë së Arkivit);
- EBU – FUNA (dedikuar Njesisë së Progmave Tematike dhe Lajmeve).

Infrastruktura në MCR/Playout dhe Montazhe)



Një skemë e përgjithshme është paraqitur në skicën e mësipërme

Burimi: RTSH

Janë lidhur kryesisht Airbox; Capture Box; Montazhet; Përpunimi Grafik etj.

Topologjia e përdorur në rrjetin e TV është TREE, pasi të gjithë departamentet e ndryshëm të televizionit janë të shpërndara në kate dhe godina të ndryshme. Në këtë infrastrukturë janë shtuar dhe montazhet e destinuar për Programet Sportive. Rjeti në çdo nyje është 1Gb/s dhe në transmetim është me 2gb/s, por me shtimin e platformës është rikthyer në 1gb/s për efekt teaming (redundance) – switch fault tolerance.

Nga auditimi u konstatua se:

- RTSH nuk disponon akt rregullativ për menaxhimin dhe administrimin e loge-ve të sigurisë/pajisjeve të institucionit;
- Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e logeve;
- pjesa e rrjetit të brendshëm është e menaxhuar me anë të switch-eve të cilat janë lidhur sipas nevojës dhe sipas rastit nga specialistët IT dhe nuk disponohet një router qendror për të bërë transkriptimin e IP për të gjithë rrjetin e RTSH, e cila sjell risk në ndërhyrjen në sistemit të brendshëm të televizionit;
- Firewall-i për sigurinë e rrjetit është aktiv por i palicensuar, çka sjell çaktivizimin e të gjitha faktorëve të mbrojtjes kur firewall-i është jashtë garancisë, gjë që mund të paraqesë rreziqe sigurie për rrjetin e networkut të gjithë RTSH-ës.

➤ **Mbi përdorimin e infrastrukturës TIK në krijimin e kushteve optimale në RTSH u konstatua se:**

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në RTSH mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe një pjesë është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet.

Siguria e informacionit mbart risqe që vijnë për shkak se sistemet e operimit apo programet e instaluar në kompjuterat dhe pajisjet pc të RTSH-ës të cilat nuk janë të gjitha të licencuara dhe nuk kanë versionet të përditësuara si dhe nuk përdorin për mbrojtje antivirus dhe nuk kanë të përditësuara sistemet e sigurisë, konkretisht:

- Pajisjet PC të disa pikave të montazhit dhe grafikës janë me parametra me ritëm të ulët të gjenerimit të materialeve video+audio;
- Pajisjet PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 85%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprerë suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të RTSH-ës vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe;
- Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;
- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara.

➤ **Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve**

Objektivi: Vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit të politikave dhe procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve.

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit sipas rasteve dhe komunikimeve elektronike. Nga komunikimet verbale ndërmjet grupit të auditimit dhe punonjësve të RTSH konstatohet se, Njësia Teknike çdo problematik që lidhet me veprimtarinë e Njesisë qoftë Hardware-ike dhe Software-ke mundohet ta zgjidhi vetë rast pas rasti, pa pasur suportin nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se RTSH, nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve për ti trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen. Duke mos realizuar identifikimin e problemeve dhe incidenteve, RTSH rrezikon që risqet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve kundrejt informimit të publikut në Republikën e Shqipërisë dhe me gjerë, etj. Pasja e procedurave të dokumentuara për zbulimin dhe regjistrimin e incidenteve dhe problemeve ul riskun e, aksesit të paautorizuar të përdoruesve edhe ndërhyrjet e paautorizuara; dështimeve të rrjetit, funksionalitetit të ulët të programeve (ofrimi i shërbimeve). Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura. Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që institucioni të mos identifikojë risqet me efekt negativ në IT dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim dhe mos lënie gjurmësh për trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e IT në RTSH.

➤ **Menaxhimi i Ndryshimit**

Objektivi: Vlerësimi nëse institucioni ka implementuar një procedurë të standardizuar për kontrollin e të gjitha ndryshimeve në sistemet dhe aplikacionet kryesore të IT. Nisur nga rëndësia e procesit të menaxhimit të ndryshimit, i cili duhet të sigurojë që ndryshimet janë regjistruar, vlerësuar, autorizuar, prioritarizuar, planifikuar, testuar, implementuar, dokumentuar dhe rishikuar në përputhje me procedurat e dokumentuara dhe të aprovuara të

menaxhimit të ndryshimit, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion. Nga intervistat e zhvilluara me personelin përgjegjës të sektorit të IT-së në RTSH, konstatohet se nuk disponohet procedurë për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve në sistem.

Referuar edhe verifikimit nga grupi i auditimit onsite në RTSH, rrjeti network dhe kabllimet në dhomën e serverave ku është alokuar e gjithë infrastruktura e Njësisë Teknike ka nevojë të përmirësohet dhe të jetë në përputhje me standartet më të mira, për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve që RTSH ofron. Në opinion të grupit të auditimit, hartimi i një plani afatgjatë për përmirësimin e ambientit teknologjik (përfshirë konfigurimet e rrjetit dhe infrastrukturës teknologjike) për mbledhjen dhe përpunimin në kohë reale të informacionit, si dhe administrimin e shpërndarjes sa më të shpejtë të të dhënave dhe materialeve të përfutura nga pajisjet dixhitale që Njësitë/ Drejtoritë/ Sektorët përkatëse të RTSH-ës disponojnë do të ndikojë në një ofrim më të mirë të shërbimit, rëndësinë që ka në funksion te interesit publik si dhe vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale.

1.Titulli i Gjetjes:	Mungesë e bazës rregullatore në lidhje me menaxhimin e sistemeve, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, sistemi MAM, QSAN dhe EPG, administrohen nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, pa një akt rregullativ për administrimin/menaxhimin e sistemit, në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e sistemit dhe përdoruesve të sistemit. Gjithashtu administratorët e sistemeve dhe detyrat përkatëse nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga organet drejtuese të RTSH, ku të jenë emëruar zyrtarisht për të ushtruar atributet e përcaktuara sipas funksioneve dhe detyrave mbi administrimin e sistemit.
Kriteri:	Neni 27, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i> , i ndryshuar; Ligji nr. 2/2017 <i>“Për sigurinë kibernetike”</i> , ISO/IEC 27001 <i>“Information security management”</i> .
Ndikimi/efekti:	Pamundësi në përcaktimin e përgjegjësive të punonjësve në lidhje me administrimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të informacionit. Mos dokumentim i të drejtave dhe detyrimeve që kanë administratorët dhe të gjithë përdoruesit e sistemit.
Shkaku:	Mos hartimi dhe miratimi i akteve rregullative në lidhje me administrimin e sistemeve që RTSH disponon.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Strukturat drejtuese në RTSH të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që RTSH ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT. Gjithashtu, RTSH të marrë masa për hartimin dhe miratimin e manualeve të përdorimit përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e fjalëkalimeve, ndryshimin e roleve dhe të drejtave të përdoruesve të RTSH.

2.Titulli i Gjetjes:	Kapaciteti storage i sistemit QSAN.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, sistemi QSAN është instaluar në datë 06.07.2023 me një hapësirë storage 573 TB dhe për një periudhë prej 4 muajsh kapaciteti storage i QSAN ka arritur në 30%. Duke parë ritmet e punës së përditshme të materialeve të cilat përpunohen dhe ruhen, kapaciteti storage i instaluar shumë shpejt do të ezaurohet duke rrishtuar funksionimin e sistemit në të ardhmen.
Kriteri:	Vazhdimësia e funksionimit të sistemit.
Ndikimi/efekti:	Mosplotësimi i kapacitetet për storage në të ardhmen, mundësia për ndërprerje dhe mosfunksionim i sistemit në të ardhmen.
Shkaku:	Mungesa e planeve të mirë përcaktuara për zhvillimin e teknologjisë së informacionit.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit të marrin masa për menaxhimin e kapacitetit storage të sistemit QSAN, në përputhje me nevojat institucionale që RTSH ka, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike për të ardhmen, me qëllim shmangien e plotësimit të kapacitetit storage dhe garantimin e vazhdimësisë së punës.

3.Titulli i Gjetjes:	Problematika të identifikuar në sistemin EPG.
Situata:	Nga auditimi mbi sistemin EPG, u konstatua se: Aktualisht serveri i këtij sistemi është jashtë funksionit dhe është migruar në një workstation model z820; Ka problematika me aksesimin e database MySQL dhe SQL; Dokumenti epg.exe kryen fshirje automatike si dhe ka problem me njohjen e karaktereve si për shembull: “ç”, “ë”, gjë kjo e cila vështirëson procesin e punës së këtij sistemi dhe nuk bënë të mundur mbylljen e tagut <desc> description (përshkrimi) </desc>; Nuk sinkronizohen materialet të cilat hidhen nga specialistë e programacionit me datën, orën sipas formatit të programit me atë të sistemit; Specialistët e Drejtorisë të Teknologjisë dhe Informacionit bëjnë dublim të punës duke i hedhur manualisht me dorë të gjithë informacionin për secilin nga programet që do transmetohet; Windows Storage Server 2012 i përdorur nuk është Aktiv duke sjellë riskun e ekspozimit ndaj dështimit dhe hakërimit.
Kriteri:	Ligji 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ISO/IEC 27001 “Information security management”, vazhdimësia e funksionimit të sistemit.
Ndikimi/efekti:	Risk për mos-evidentimin dhe mos-parandalimin e problematikave që lidhen me performancën e funksionimit të sistemit.
Shkaku:	Mos marrja e masave paraprake për parandalimin e problematikave që lidhen me performancën e funksionimit jo të mirë të sistemit.

Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit si dhe me Njësinë e Programeve të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin, adresimin e parregullsive, përmirësimin dhe rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete për to me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit.

4.Titulli i Gjetjes:	Keqmenaxhimi i sistemit storage në RTSH, ndërprerja e menaxhimit dhe administrimit të sistemi MAM.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, storage i Isilon Data Storage me një hapësirë storage rreth 912.55 TB ku ruhen të gjitha materialet multimediale online të ruajtura ndër vite ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit të mundshëm për ruajtjen e materialeve arkivore.</p> <p>Nga auditimi mbi sistemin MAM, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Sistemi MAM nuk është shfrytëzuar dhe nuk është përdorur nga RTSH si një sistem informatik i menaxhimit të aseteve Multimediale, me qëllim ndërlidhjen dhe shkëmbimin e informacioneve të të gjitha nënsistemeve të tjera si për playout, livestream, VOD (platforma OTT) etj. -Për një periudhë 1 vjeçare sistemi MAM është pa mirëmbajtje; -RTSH ka patur 2 specialistë të certifikuar për përdorimin e sistemit MAM, të cilët i kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me RTSH dhe aktualisht sistemi MAM nuk menaxhohet dhe administrohet nga asnjë punonjës i autorizuar. Në kushtet aktuale që ndodhet ky sistem dhe mënyra sesi menaxhohet, rrezikon ndërprerjen dhe e bënë të pamundur për ta rikthyer sistemin në gjendjen fillestare.
Kriteri:	Vazhdimësia e funksionimit të sistemit.
Ndikimi/efekti:	Ndërprerje dhe pamundësia për ta rikthyer sistemin në gjendjen fillestare.
Shkaku:	Mungesa e planeve të mirë përcaktuara për zhvillimin e teknologjisë së informacionit.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit si dhe Drejtorinë e Arkivës të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me qëllim vlerësimin, analizimin dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete në lidhje me menaxhimin e file-ve të ruajtura në storage e sistemit MAM.
4.2 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për mos lënien e sistemit pa mirëmbajtje duke ngritur grupe pune të brëndshme për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e sistemit/storage si dhe trajnim e stafit në lidhje me sistemin MAM, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

5.Titulli i Gjetjes:	Mungesa e dokumentimit të rrjedhës së informacionit “Workflow” për hapat që kryhen nëpërmjet sistemeve në RTSH, si dhe mungesa e menaxhimit të logeve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se: RTSH nuk disponon Workflow apo Diagramë të qarkullimit të informacionit për secilin sistem që përdor. Nuk u administrua asnjë informacion se çfarë ndodh me menaxhimin e rrjetit DATA në të gjithë rrjetin e RTSH; RTSH nuk disponon akt rregullativ për menaxhimin dhe administrimin e loge-ve të sistemit/ pajisjeve të institucionit, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e logeve.
Kriteri:	Standardet më të mira dhe neni 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Gjurma e auditimit”, rregullore për “Menaxhimin e Log-eve digjitale në administratën publike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e dokumentimit të diagrameve shpjeguese se si informacioni rrjedh në sistemet e TI që mbështesin proceset e institucionet në vazhdimësi të plotësisht të gjurmës së auditimit, krijojnë pengesa në të paktën 3 drejtime, për: Kuptimin; Vlerësimin; Gjurmimin.
Shkaku:	Neni 16, pika 2 e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, janë titullarët e njësive publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Mos zbatim i rregullores miratuar nga AKCESK.
Rëndësia:	E Lartë
5.1 Rekomandimi:	Strukturat Drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit t’i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave. Gjithashtu të marrin masa që të hartojnë dhe dokumentojnë diagramat e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemeve me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatik.
6.Titulli i Gjetjes:	Mungesa e manualeve të përdorimit dhe parregullsi që i adresohen politikave të sigurisë së identifikimit të përdoruesve.
Situata:	Nga auditimi mbi sistemet kryesore që RTSH përdor u konstatua se: - nuk disponohet një manual përdorimi për përdoruesit e sistemit;

	<ul style="list-style-type: none"> - nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK5 me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. - Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. - Për sistemin EPG fjalëkalimi për administratorin nuk është ndryshuar dhe pse personeli dhe stafi i IT është ndryshuar ndër vite, fjalëkalimet janë trashëguar nga një punonjës tek tjetri pa u përditësuar duke sjellë risk në akses të paautorizuar.
Kriteri:	Pika 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a, e rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; Forcimin i fjalëkalimit si element sigurie është në standardin “Two Factor Authentication”. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/efekti:	Mos përcaktim dhe mosnjohje e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të gjithë përdoruesit e sistemit.
Shkaku:	Mungesa e rregullave të dokumentuara dhe implementimi i tyre mbi sigurinë e fjalëkalimeve të përdoruesve.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e manualeve të përdorimit për sistemet që ka në përdorim duke reflektuar ndryshimet institucionale dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite. Gjithashtu të marrin masa për të dokumentuar dhe aplikuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e këtyre sistemeve, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK.
7.Titulli i Gjetjes:	RTSH nuk disponon një infrastrukturë BCC për sistemet që disponon, si dhe nuk disponon një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit dhe procedurat e backup.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se: <ul style="list-style-type: none"> - RTSH nuk disponon një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center) si dhe nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery), me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013.

	<p>- procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RTSH. Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to. Administrimi i këtyre attributeve individualisht dhe pa autorizim, nuk jep siguri të arsyeshme për kryerjen e tyre sipas praktikave më të mira;</p> <p>- aktualisht bëhet backup në sistemin LTO (back up offline) vetëm Isilon Data Storage, dhe asnjë nga sistemet e tjera si Storeeasy, EPG apo sistemi aktual QSAN.</p>
Kriteri:	VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar, dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (COBIT dhe Manuali i Auditimit IT).
Ndikimi/efekti:	Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.
Shkaku:	Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e Business Continuity për sistemet që janë në përdorim nga RTSH.
7.2 Rekomandimi:	RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e Business Continuity për sistemet që janë në përdorim nga RTSH. Gjithashtu RTSH të marrë masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të rikuperimi nga katastrofa (disaster recovery) duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.
8.Titulli i Gjetjes:	Konfigurimet e Active Directory nuk janë të konfiguruar në përputhje me standardet më të mira.
Situata:	<p>Nga auditimi i Active Directory u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Windows Server 12 R2 i përdorur për Active Directory nuk është Aktiv duke ekspozuar ndaj dështimit dhe hakerimit; - Nuk ka të instaluar antivirus; - Nuk janë bërë përditësimet e fundit, e cila riskon moskthimin në gjendje të mëparshme të Active Directory Domain Services; - Detyra e Administratorit të bazës së të dhënave të Active Directory nuk i janë atribuar me anë të shkresës zyrtare nga strukturat drejtuese të RTSH asnjë specialisti të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit; - ka punonjës të cilët janë në strukturën e RTSH dhe nuk kanë user në Active Directory;

	<ul style="list-style-type: none"> - ekzistojnë usera të cilët nuk janë më punonjës në RTSH dhe janë aktiv; - ekzistojnë Njësi Organizative në sistem të cilat janë të pa emërtuara dhe janë me emrin -> Unkown; - ekzistojnë usera të cilët janë të pa identifikueshëm me emra “test”, “usrbms”, “usrdm”, “usrtx” si dhe shumë raste të tjera të cilat sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistemet dhe në rrjetin e RTSH, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar; - konfigurimet e Active Directory janë të konfiguruar by default dhe nuk janë të konfiguruar në përputhje me standardet me të mira.
Kriteri:	<p>Politikat e Sigurisë së Informacionit (Referuar ISO 27000). ISO/IEC 27002:2013</p> <p>Për praktikën më të mira mbi konfigurimin e politikave të sigurisë (GPO) së Active Directory, referojuni sa më poshtë:</p> <p>http://technet.microsoft.com/en-us/library/cc773365(WS.10).aspx</p> <p>Strong passwords: http://technet.microsoft.com/en-us/library/cc728372(WS.10).aspx</p> <p>Password requirements: http://technet.microsoft.com/en-us/library/cc772803(WS.10).aspx</p> <p>Complex password: http://technet.microsoft.com/en-us/library/cc786468(WS.10).aspx http://technet.microsoft.com/en-us/library/cc773388(WS.10).aspx http://technet.microsoft.com/en-us/library/cc780182(WS.10).aspx</p>
Ndikimi/efekti:	<p>Disa nga risqet që vijnë si rezultat i mos konfigurimeve të duhura dhe default i Active Directory:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston rreziku i mos menaxhimit të politikave që mund t'i lejojë përdoruesit të marrin shumë të drejta; - Rreziku që politikat e fjalëkalimit nuk janë në përputhje me kërkesat e institucionit ose praktikën më të mira. Kjo mund ta bëjë më të lehtë për personat e paautorizuar qasjen në rrjet dhe sisteme; - Fjalëkalimet që nuk skadojnë kurrë mund të rezultojnë në akses të paautorizuar; - Llogaria e një përdoruesi me një fjalëkalim bosh mund të rezultojë në akses të paautorizuar.
Shkaku:	<p>Mos zbatim praktikave më të mira (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit). ISO/IEC 27002:2013, http://technet.microsoft.com/enus/library/cc773365(WS.10).aspx</p>
Rëndësia:	E lartë.
8.1 Rekomandimi:	<p>Drejtorja e Teknologjisë dhe Informacionit të marrë masa për analizimin e situatës të evidentuar nga auditimi për konfigurimin e politikave të sigurisë së Active Directory dhe të realizojë konfigurimet përkatëse në përputhje me standardet me të mira, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së aksesit dhe standardizimin e infrastrukturës IT. Gjithashtu të marrin masa për licensimin e Windows Server 12 R2 i përdorur për Active Directory, pajisjen me antivirus dhe update në mënyrë automatike të Active Directory</p>

9.Titulli i Gjetjes:	Problematika të konstatuar në dhomën e serverëve dhe në infrastrukturën e rrjetit të RTSH.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, dhoma e serverëve në të cilën është lokalizuar e gjithë infrastruktura Hardware/Software/Network e Njësisë Teknike nuk përmbush asnjë nga kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar; · Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve; · Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuara; · Nuk ka sistem kondicionimi, ftofja e ambientit realizohej me freskuse; · Ambienti ku është lokalizuar dhoma e serverëve është i ndërtuar me dyer xhami, faktor i cili ul sigurinë për në dhomën e serverëve; · Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit; · Nuk ka të instaluar BMS (Building Managment System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik; <p>Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave ku janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ke që RTSH disponon e cila përmbush disa nga parametrat TIK të përcaktuara nga AKSHI për ndërtimin e dhomës së Serverave, gjithashtu u konstatuan disa problematika, konkretisht si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga auditimi i procedurës së administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një akt rregullativ të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje-dalje të personave të paautorizuar. Në dhomën e serverave ka akses i gjithë stafi i Drejtorisë të Teknologjisë dhe informacionit dhe një pjesë e punonjësve nga njësia teknike dhe nga sektori elektrikës, të cilët nuk janë të autorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TIS-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës; - Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, etj) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj; - Gjenden rack të cilët nuk janë në përdorim si dhe nuk kanë asnjë pajisje elektronike dhe elektrike të instaluar në to; - Sistemi i kondicionimit përbëhej nga 4 kondicioner, nga të cilët 2 prej tyre janë funksional dhe 2 janë në alert (alarm), duke ndikuar negativisht në mbajtjen e parametrave optimal në ftohjen e duhur të serverave.
Kriteri:	Rregullorja për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI. Infrastruktura të jetë e standardizuar sipas praktikave më të mira, Operacionet e rrjetit

	menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurtë dhe efektive. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT).
Ndikimi/efekti:	Mos garantim i vazhdimësisë së punës, risk për thyerje të sigurisë.
Shkaku:	Mos zbatimit i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Mos zbatim i bazës rregullatore mbi standardet dhe sigurinë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.
Rëndësia:	E lartë.
9.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Njësinë Teknike të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin dhe vlerësimin në lidhje me kalimin e infrastrukturës Hardware-ike dhe Software-ike të Njësisë Teknike, e cila nuk plotëson kushtet standarde dhe teknike në ambjentin e dhomës së serverave ku janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ike që RTSH disponon, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI.
9.2 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për përmirësimin e ambienteve të dhomës së serverave, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

10.Titulli i Gjetjes:	Infrastruktura TIK në RTSH nuk plotëson kushtet e nevojshme optimale për veprimtarinë e RTSH.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, shërbimet që ofrohen me anë të teknologjisë së informacionit në RTSH mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe një pjesë e saj është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet, konkretisht:</p> <p>Pajisjet PC të disa pikave të montazhit dhe grafikës janë me parametra minimale të gjenerimit të materialeve video+audio;</p> <p>Pajisjet PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 85%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të RTSH-ës vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe;</p> <p>Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;</p> <p>Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;</p> <p>Pjesa e rrjetit të brendshëm është e menaxhuar me anë të switch-eve të cilat janë lidhur sipas nevojës dhe sipas rastit nga specialistët IT dhe nuk disponohet një router qendror për të bërë transkriptimin e IP për të gjithë rrjetin e RTSH, e cila sjell risk në ndërhyrjen në sistemit të brendshëm të televizionit;</p> <p>Firewall-i për sigurinë e rrjetit është aktiv por i palicensuar, çka sjell çaktivizimin e të gjitha faktorëve të mbrojtës kur firewall-i është jashtë garancisë, gjë që mund të paraqesë rreziqe sigurie për rrjetin e networkut të gjithë RTSH-ës.</p>

Kriteri:	Infrastruktura TIK sipas praktikave më të mira. Standardizimi i veprimeve për zgjidhjen e problemeve dhe dokumentimi i tyre. Infrastruktura të jetë e standardizuar sipas praktikave më të mira, Operacionet e rrjetit menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurtë dhe efektive. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT).
Ndikimi/efekti:	Mos garantim i vazhdimësisë së punës, risk për thyerje të sigurisë. Situatat zgjidhen rast pas rasti në mënyrë telefonike dhe janë të padokumentuara.
Shkaku:	Mos zbatimit i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Mungesa e mirëadministrimit, mos zbatimit i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network.
Rëndësia:	E lartë.
10.1 Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standartizimin e infrastrukturës IT sipas praktikave më të mira, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje dhe ofrimin e shërbimeve duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike në RTSH, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.

11.Titulli i Gjetjes:	Mos dokumentimi dhe menaxhimi i incidenteve, problemeve dhe ndryshimeve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se RTSH, nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve për ti trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.
Kriteri:	Manuali i auditimit IT, praktikat më të mira.
Ndikimi/efekti:	Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.
Shkaku:	Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
Rëndësia:	E mesme.
11.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, dokumentimin, trajtimin dhe monitorimin e incidenteve, si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e gjithë procesit të ndryshimeve.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Aktkonstatimi nr.3, datë 13.11.2023, protokolluar në RTSH me nr. 2006/3, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 32-58 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në strukturën e miratuar RTSH ka një numër total prej 1039 punonjësish, nga të cilat 81 janë pozicione vakante. Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (DTI), e përbërë nga 9 punonjës, nga të cilat dy pozicione janë vakante. Pozicionet vakante në këtë drejtori janë kyçe pasi janë përkatësisht pozicioni i Drejtorit (aktualisht i komanduar) dhe i ai Inxhinierit IT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: RTSH të marrë masa për plotësimin e kapaciteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit nuk është kryer ndarja e detyrave dhe përgjegjësive të specialistëve të IT edhe pse nevoja për asistencën e Specialistëve IT është e madhe, sidomos nga Njësia Teknike në Radio, Televizion dhe Administrata e Institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: RTSH të marrë masa për përditësimin e rregullores duke bërë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të specialisteve IT në institucion, në mënyrë që të gjitha drejtoritë të kenë suportin e nevojshëm për kryerjen e objektivave të caktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se specialistët e TI në RTSH nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni dhe strukturat drejtuese në RTSH nuk kanë një plan të hartuar dhe miratuar mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: RTSH të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime për rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që të nxis dhe të përmirësojë kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se RTSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me praktikën më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion; rregulla mbi menaxhimin e incidenteve; procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre; struktura kontrolli për verifikimin e efektivitetit të ndryshimeve të kryera; procedura për ndryshimet emergjente si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandim: RTSH të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të shoqërisë si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se raportet vjetore të veprimtarisë së RTSH-së për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar nga Këshilli Drejtues i RTSH, si dhe nuk janë të publikuara në faqen e saj të web-it.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Këshilli Drejtues dhe RTSH të marrin masa për hartimin dhe publikimin në faqen web ta raporteve vjetore të veprimtarisë së institucionit sipas përcaktimit të dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se RTSH nuk disponon një regjistër risku, ku të përfshihen dhe risqet mbi Teknologjinë e Informacionit, në mospërputhje me të Nenin 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandim: RTSH të marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin e një regjistri risku për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun e Teknologjisë së Informacionit në institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në RTSH, për periudhën objekt auditimi, nuk ka zhvilluar asnjë auditim me fokus mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (5-18) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime IT, me qëllim ekzaminimin e sistemeve të IT për të garantuar se ato përmbushin nevojat e subjektit pa komprometuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së RTSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor", për vitin 2021, në kontratën e lidhur midis Autoriteti Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik fitues nuk është përcaktuar shprehimisht dërgimi i raporteve mujore të mirëmbajtjes nga ana e operatorit ekonomik. Funksionimi i sistemit mbikëqyret vetëm nga grupi i punës për marrjen në dorëzim i cili harton një procesverbal çdo muaj në momentin e pagesës së faturës nga RTSH, ndërsa operatori ekonomik nuk mban asnjë raport mujor për monitorimet përkatëse të ecurisë, KPI-ve apo problematikave të pajisjeve Mediakind Ericsson C2 Box System. Pra, detyrën e OE e ka kryer grupi i marrjes në dorëzim, i cili, njëkohësisht, merr në dorëzim mbikëqyrjen që ka bërë vetë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (18-35) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandim: RTSH të marrë masa që në hartimin e kontratave për mirëmbajtjen e sistemeve në të ardhmen, të mirëpërcaktojë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë me qëllim matjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të kontraktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se titullari i Autoritetit Kontraktor, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël "Blerje kompjuter për RTSH", për vitin 2021, nuk ka ngritur urdhër për përcaktimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit të prokuruar. Malli është marrë në dorëzim nga vetë Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (18-35) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i RTSH të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara, në përputhje me kriteret dhe

specifikimet e kërkuara dhe si detyrë funksionale që i buron nga roli si titullar i Autoritetit Kontraktor.

10.Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se në procedurën e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje për Head-End-in satelitor”, për vitin 2021, dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (18-35))

10.1.Rekomandim: RTSH, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe personat e autorizuar për hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, të marrin masa që për procedurat që do të zhvillohen në vijimësi të përmbushin të gjitha përcaktimet e dispozitave ligjore dhe proceduriale në fushën e arkivimit të dosjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sistemi MAM, QSAN dhe EPG, administrohen nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, pa një akt rregullativ për administrimin/menaxhimin e sistemit, në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e sistemit dhe përdoruesve të sistemit. Gjithashtu administratorët e sistemeve dhe detyrat përkatëse nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga organet drejtuese të RTSH, ku të jenë emëruar zyrtarisht për të ushtruar atributet e përcaktuara sipas funksioneve dhe detyrave mbi administrimin e sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese në RTSH të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që RTSH ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT.

Gjithashtu, RTSH të marrë masa për hartimin dhe miratimin e manualeve të përdorimit përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e fjalëkalimeve, ndryshimin e roleve dhe të drejtave të përdoruesve të RTSH.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sistemi QSAN është instaluar në datë 06.07.2023 me një hapësirë storage 573 TB dhe për një periudhë prej 4 muajsh kapaciteti storage i QSAN ka arritur në 30%. Duke parë ritmet e punës së përditshme të materialeve të cilat përpunohen dhe ruhen, kapaciteti storage i instaluar shumë shpejt do të ezaurohet duke rrishtuar funksionimin e sistemit në të ardhmen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit të marrin masa për menaxhimin e kapacitetit storage të sistemit QSAN, në përputhje me nevojat institucionale që RTSH ka, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike për të ardhmen, me qëllim shmangien e ezaurimit të kapacitetit storage dhe garantimin e vazhdimësisë së punës.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin EPG, u konstatua se:

- Aktualisht serveri i këtij sistemi është jashtë funksionit dhe është migruar në një workstation model z820;
- Ka problematika me aksesimin e database MySql dhe SQL;
- Dokumenti epg.exe kryen fshirje automatike si dhe ka problem me njohjen e karaktereve si për shembull: “ç”, “ë”, gjë kjo e cila vështirëson procesin e punës së këtij sistemi dhe nuk bënë të mundur mbylljen e tagut <desc> description (përshkrimi) </desc>;

- Nuk sinkronizohen materialet të cilat hidhen nga specialistë e programacionit me datën, orën sipas formatit të programit me atë të sistemit;
- Specialistët e Drejtorisë të Teknologjisë dhe Informacionit bëjnë dublim të punës duke i hedhur manualisht me dorë të gjithë informacionin për secilin nga programet që do transmetohet;
- Windows Storage Server 2012 i përdorur nuk është Aktiv duke sjellë riskun e ekspozimit ndaj dështimit dhe hakërimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandim: Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit si dhe me Njësinë e Programeve të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin, adresimin e parregullsive, përmirësimin dhe rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete për to me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, storage i Isilon Data Storage me një hapsirë storage rreth 912.55 TB ku ruhen të gjitha materialet multimediale online të ruajtura ndër vite ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit të mundshëm për ruajtjen e materialeve arkivore.

Nga auditimi mbi sistemin MAM, u konstatua se:

- Sistemi MAM nuk është shfrytëzuar dhe nuk është përdorur nga RTSH si një sistem informatik i menaxhimit të aseteve Multimediale, me qëllim ndërlidhjen dhe shkëmbimin e informacioneve të të gjitha nënsistemeve të tjera si për layout, livestream, VOD (platforma OTT) etj.
- Për një periudhë 1 vjeçare sistemi MAM është pa mirëmbajtje;
- RTSH ka patur 2 specialistë të certifikuar për përdorimin e sistemit MAM, të cilët i kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me RTSH dhe aktualisht sistemi MAM nuk menaxhohet dhe administrohet nga asnjë punonjës i autorizuar. Në kushtet aktuale që ndodhet ky sistem dhe mënyra sesi menaxhohet, rrezikon ndërprerjen dhe e bënë të pamundur për ta rikthyer sistemin në gjendjen fillestare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandim: Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit si dhe Drejtorinë e Arkivës të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me qëllim vlerësimin, analizimin dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete në lidhje me menaxhimin e file-ve të ruajtura në storage e sistemit MAM. Gjithashtu RTSH të marrë masa për mos lënien e sistemit pa mirëmbajtje duke ngritur grupe pune të brendshme për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e sistemit/storage si dhe trajnim e stafit në lidhje me sistemin MAM, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

Menjëherë

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- RTSH nuk disponon Workflow apo Diagramë të qarkullimit të informacionit për secilin sistem që përdor.
- Nuk u administrua asnjë informacion se çfarë ndodh me menaxhimin e rrjetit DATA në të gjithë rrjetin e RTSH;
- RTSH nuk disponon akt rregullativ për menaxhimin dhe administrimin e loge-ve të sistemit/ pajisjeve të institucionit, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT);
- Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e logeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandim: Strukturat Drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit t'i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave. Gjithashtu të marrin masa që të hartojnë dhe dokumentojnë diagramat e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemeve me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatik.

Brenda vitit 2024

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemet kryesore që RTSH përdor u konstatua se:

- nuk disponohet një manual përdorimi për përdoruesit e sistemit;
- nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK5 me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
- Për sistemin EPG fjalëkalimi për administratorin nuk është ndryshuar dhe pse personeli dhe stafi i IT është ndryshuar ndër vite, fjalëkalimet janë trashëguar nga një punonjës tek tjetri pa u përditësuar duke sjellë risk në akses të paautorizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandim: RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e manualeve të përdorimit për sistemet që ka në përdorim duke reflektuar ndryshimet institucionale dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite. Gjithashtu të marrin masa për të dokumentuar dhe aplikuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e këtyre sistemeve, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- RTSH nuk disponon një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center) si dhe nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery), me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013;
- procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RTSH. Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to. Administrimi i këtyre attributeve individualisht dhe pa autorizim, nuk jep siguri të arsyeshme për kryerjen e tyre sipas praktikave më të mira;
- aktualisht bëhet backup në sistemin LTO (back up offline) vetëm Isilon Data Storage, dhe asnjë nga sistemet e tjera si Storeeasy, EPG apo sistemi aktual QSAN.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandim: RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarri hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e Business Continuity për sistemet që janë

në përdorim nga RTSH. Gjithashtu RTSH të marrë masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të rikuperimi nga katastrofa (disaster recovery) duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Active Directory u konstatua se:

- Windows Server 12 R2 i përdorur për Active Directory nuk është Aktiv duke ekspozuar ndaj dështimit dhe hakerimit;
- Nuk ka të instaluar antivirus;
- Nuk janë bërë përditësimet e fundit, e cila riskon moskthimin në gjendje të mëparshme të Active Directory Domain Services;
- Detyra e Administratorit të bazës së të dhënave të Active Directory nuk i janë atribuar me anë të shkresës zyrtare nga strukturat drejtuese të RTSH asnjë specialisti të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit;
- ka punonjës të cilët janë në strukturën e RTSH dhe nuk kanë user në Active Directory;
- ekzistojnë usera të cilët nuk janë më punonjës në RTSH dhe janë aktiv;
- ekzistojnë Njësi Organizative në sistem të cilat janë të pa emërtuara dhe janë me emrin -> Unkown;
- ekzistojnë usera të cilët janë të pa identifikueshëm me emra “test”, “usrbms”, “usrdm”, “usrtx” si dhe shumë raste të tjera të cilat sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistemet dhe në rrjetin e RTSH, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar;
- konfigurimet e Active Directory janë të konfiguruar by default dhe nuk janë të konfiguruar në përputhje me standardet me të mira.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1.Rekomandim: Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit të marrë masa për analizimin e situatës të evidentuar nga auditimi për konfigurimin e politikave të sigurisë së Active Directory dhe të realizojë konfigurimet përkatëse në përputhje me standardet me të mira, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së aksesit dhe standardizimin e infrastrukturës IT. Gjithashtu të marri masa për licensimin e Windows Server 12 R2 i përdorur për Active Directory, pajisjen me antivirus dhe update në mënyrë automatike të Active Directory.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, dhoma e serverëve në të cilën është lokalizuar e gjithë infrastruktura Hardware/Software/Network e Njësisë Teknike nuk përmbush asnjë nga kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), më konkretisht:

- Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuara;
- Nuk ka sistem kondicionimi, ftofja e ambientit realizohej me freskuse;
- Ambienti ku është lokalizuar dhoma e serverëve është i ndërtuar me dyer xhami, faktor i cili ul sigurinë për në dhomën e serverëve;
- Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;

- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik;

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave ku janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ke që RTSH disponon e cila përmbush disa nga parametrat TIK të përcaktuara nga AKSHI për ndërtimin e dhomës së Serverave, gjithashtu u konstatuan disa problematika, konkretisht si më poshtë:

- Nga auditimi i procedurës së administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një akt rregullativ të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje-dalje të personave të paautorizuar. Në dhomën e serverave ka akses i gjithë stafi i Drejtorisë të Teknologjisë dhe informacionit dhe një pjesë e punonjësve nga njësitë teknike dhe nga sektori elektrikës, të cilët nuk janë të autorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TI-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës;
- Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, etj) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj;
- Gjenden rack të cilët nuk janë në përdorim si dhe nuk kanë asnjë pajisje elektronike dhe elektrike të instaluar në to;
- Sistemi i kondicionimit përbëhet nga 4 kondicioner, nga të cilët 2 prej tyre janë funksional dhe 2 janë në alert (alarm), duke ndikuar negativisht në mbajtjen e parametrave optimal në ftohjen e duhur të serverave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1.Rekomandim: Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Njësinë Teknike të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin dhe vlerësimin në lidhje me kalimin e infrastrukturës Hardware-ike dhe Software-ike të Njësisë Teknike, e cila nuk plotëson kushtet standarde dhe teknike në ambientin e dhomës së serverave ku janë lokalizuar pjesa tjetër Hardware-ike dhe Software-ike që RTSH disponon, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI.

19.2.Rekomandim: RTSH të marrë masa për përmirësimin e ambienteve të dhomës së serverave, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, shërbimet që ofrohen me anë të teknologjisë së informacionit në RTSH mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe një pjesë e saj është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet, konkretisht:

- Pajisjet PC të disa pikave të montazhit dhe grafikës janë me parametra minimale të gjenerimit të materialeve video+audio;
- Pajisjet PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 85%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprerë suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të RTSH-ës vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe;
- Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;
- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;
- Pjesa e rrjetit të brendshëm është e menaxhuar me anë të switch-eve të cilat janë lidhur sipas nevojës dhe sipas rastit nga specialistët IT dhe nuk disponohet një router qendror për të bërë

transkriptimin e IP për të gjithë rrjetin e RTSH, e cila sjell risk në ndërhyrjen në sistemit të brendshëm të televizionit;

- Firewall-i për sigurinë e rrjetit është aktiv por i palicensuar, çka sjell çaktivizimin e të gjitha faktorëve të mbrojtës kur firewall-i është jashtë garancisë, gjë që mund të paraqesë rreziqe sigurie për rrjetin e networkut të gjithë RTSH-ës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1.Rekomandim: RTSH të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standartizimin e infrastrukturës IT sipas praktikave më të mira, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje dhe ofrimin e shërbimeve duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike në RTSH, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se RTSH, nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (35-62) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1.Rekomandim: Organet drejtuese në RTSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, dokumentimin, trajtimin dhe monitorimin e incidenteve, si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e gjithë procesit të ndryshimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT